




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gjiçani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e katërt (IV) e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 19.3. 2014 me këtë:

REND TË PUNËS

- 1 Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2 Betimi i anëtarëve të rinj të kuvendit
- 3 Zgjedhja e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për komunitete
- 4 **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - a) Raporti financiar janar-dhjetor 2013
 - b) Propozim rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01.nr.16-10498 (30.01.2013)
 - c) Propozim vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2012 dhe 2013 në vitin fiskal 2014
 - d) Miratimi i Planit të punës të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2014
 - e) Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
 - f) Propozim Vendimi paraparak për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës
 - g) Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës
 - h) Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit për vlerësimin e ankesave
 - i) Propozim vendimi për anulimin e vendimit 01.nr.119106 dhe 119115 të datës 16.10.2012 (Komisioni komunal i aksionarëve në "Kosovatrans" dhe "Eco-Higjiena")
 - j) Zgjedhja e tre anëtarëve nga KK-Gjilan, në Kuvendin e AKK-së
 - k) Diskutim rreth Kompensimit të Komisionit të përhershëm statutar dhe akte tjera normative

5 Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 10.10 min

Në punimet e seancës së katërtë morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri

Drejtorët e Drejtorive Komunale

Përfaqësuesi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, z. Fazli Abdullahu
Përfaqësuesi i OJQ “Anamorava”, z. Isa Shefkiu
Përfaqësuesi i OJQ “Vullneti Rinor”, Avni Elezi
Përfaqësuesi i KCKC, Hekuran Aliu
Përfaqësuesi i OSB-së Irfan Ukshini
Mediet

Seancën e katërt e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesja e Kuvendit e cila fillimisht e përshëndeti, kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, drejtorët e drejtorive, mediet dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në punimet e kësaj seance

Rendin e punës për këtë seancë e keni marrë me kohë, por së pari kërkoj nga sekretaria që ta verifikojë prezencën e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë?

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Nga e sekretarisë u konstatua se në punimet e kësaj seance ishin të pranishëm 34 anëtarë, kurse mungoi një (1): Bajram Hasani.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – ka kuorum për të vazhduar me punë, prandaj nëse dikush ka ndonjë, propozim, plotësim ose ndryshim në rend të punës le ta marrin fjalën?

Avdyl Aliu- në emër të grupit të anëtarëve të Kuvendit kërkoj që nga rendi i punës të hiqet pika tre (3), sepse ende nuk e kemi pajtueshmëri të plotë për zgjedhje të zëvendës kryesuesit të komuniteteve. Mendoj se së shpejti do të gjejmë mirëkuptim dhe do ta rikthejmë këtë pikë në rend të punës.

Sahit Abazi- sa i përket rendit të ditës, ne kërkojmë që të hiqet pika “F”- Propozim –vendimi për dhënie në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës dhe të dy pikat e tjera të cilat janë të ndërlidhura me këtë.

Gjithashtu kërkojmë që të hiqet edhe pika (I) – Propozim vendimi për anulimin e vendimit 01.nr.119106 dhe 119115 të datës 16.10.2012 (Komisioni komunal i aksionarëve në “Kosovatrans” dhe “Eco-Higjiena”)

Lidhur me pikën ‘ F’ kemi një shkelje procedurale, sepse kjo pikë do të duhej të kalonte në Komitetin për Shërbime Publike e cila nuk ka ndodhur, por po ashtu është vepruar edhe me dy tri pika të cilat ndërlidhen me këtë pikë.

Edhe për pikën “I” në KPF e kemi pasur një shkelje procedurale, sepse nuk kemi pasur kurrfarë materiali lidhur me këtë pikë si anëtarë të këtij komiteti, por kjo pikë ka hyrë në rend punë ad-hok. Mirëpo nën të ndryshme kërkojmë informatë nga kryetari i Komunës për përleshjen fizike që ka ndodhur në Komunës në mes dy zyrtarëve, njëri nga Zyra e Prokurimit, kurse tjetri nga Zyra e Projekteve.

Nga kryesuesja kërkojmë informatë zyrtare për këshilltaren e LDK-së e cila po vazhdon për ta shkel ligjin, sepse po i mban dy poste edhe atë të anëtares së Kuvendit por edhe të vendësdrojtores së shkollës, është fjala për Florinë Jerliun.

Gjithashtu kërkojmë informatë edhe nga kryesuesja e Kuvendit e cila edhe është edhe punëtoressë e shkollës, por edhe kryesuese e Kuvendit (të na jep sqarime pse i mban dy pozita) dhe cila është paga bazë e kryesuese?

Bujar Nevzadi- unë kërkoj nga kryesuesja e Kuvendit ta respektoj detyrën që e ka, sepse në takimin e fundit të KPF-së kemi kërkuar që të hyjë në rend të punës Informatë për largimin e disa punëtorëve nga Shërbimi Civil Komunal dhe pranimi i të tjerëve. Ne këtë e kemi votuar me të gjitha votat, prandaj kryesuesja nuk ka pasur të drejtë ta anashkalojë këtë pikë të rendit të punës!

Nën dy kërkoj nga kryetari Haziri që të na jep informatë lidhur me vizitën që e ka pasur në Amerikë dhe Holandë. Çfarë dobie ka pasur Komuna nga këto vizita dhe çfarë përfitime ka pasur Gjilani nga këto vizita? Sa ka pasur shpenzime dhe informata të tjera.

Kryetari Haziri ka qenë edhe ministër i PL, prandaj i njeh procedurat dhe duhet të na njoftojë se kush është emëruar drejtor i drejtorive përkatëse të Komunës?

Shukrie Rapuca- unë nën të ndryshme kërkoj informatë nga drejtori i Arsimit lidhur me bartjen e nxënësve (transportin e nxënësve) të Shkollës së Mesme të Bujqësisë. Për shkak të mos subvencionimit të udhëtimit, disa nxënës e kanë ndërprerë edhe shkollën, andaj të jap sqarime drejtori pse ka ndodhur kjo?

Fatbardha Selmani –nën të ndryshme kërkojmë informatë lidhur me aktorët e qytetit të Gjilanit e të cilët qe plotë tre muaj nuk kanë marrë paga, do të thotë prej që kur në krye të komunës ka ardhë udhëheqja e re. Aktorët e Teatrit kanë pasur kontrata të qëndrueshme pune, prandaj kërkojmë informatë se për çfarë arsyeje po ndodh kjo?

Arben Mehmeti-sa i përket pikave të rendit të punës, janë rekomandime të KPF-së dhe proceduralisht mund të ketë ndonjë defekt, por përderisa nuk i kemi krijuar komitetet përkatëse e për të cilat arsyeje fajtores janë partitë opozitare, sepse nuk e kanë respektuar Statutin e Komunës dhe shumica e atyre anëtarëve të komiteteve janë jo anëtarë të Kuvendit. Kjo nuk është e lejuar me statut dhe faji i mbetet opozitës për shkak të rekomandimeve jo adekuate dhe në kundërshtim me statutin e Komunës.

Sahit Abazi- opozita i ka dërguar emrat me kohë, por është LDK-ja dhe ndonjë parti tjetër që është vonuar, kurse PDK, absolutisht nuk është vonuar. Faji është i partive në pushtet dhe për këtë ne nuk mbajmë përgjegjësi!

Nevzad Isufi- unë dëshiroj të bëj një propozim lidhur me miratimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2014, sepse në ndërkohë në janë konstituuar komitetet e të cilat komitete duhet të jenë pjesë e Planit të punës dhe komitetet duhet të sjellin propozimet për punët që do të bëhen brenda këtij viti dhe ato propozime duhet të hyjnë në plan të punës së Kuvendit.

Mendoj se së pari ka desh të themelohen komitetet dhe pastaj të sillen planet e punës së komiteteve dhe mandej të aprovohet plani i punës për vitin 2014. Pasi që kjo nuk është bërë ende unë mendoj se kjo pikë ka qenë desh të shtyhet derisa të themelohen komitetet.

Gjithashtu edhe unë nuk pajtohem me atë se ne nuk i kemi dërguar emrat anëtarëve të komiteteve, sepse ne ndër të parët i kemi dërguar këta emra.

Riad Rashiti- atë që e thotë Arbeni se komitetet nuk kanë qenët të themeluara për të punuar sipas procedurave, mendojmë ashtu është, por ne bazohemi në ligj. Së pari pika “I” : Propozim vendimi për anulimin e vendimit 01.nr.119106 dhe 119115 të datës 16.10.2012 (Komisioni komunal i aksionarëve në “Kosovatrans” dhe “Eco-Higjiena”, nuk është ligjor. Ky propozim –vendim gjëja se është i bazuar në statutin e Komunës, por nuk është në baza ligjore për shkarkimin e këtyre dy komisioneve. Neni 39.1 thotë ; (citohet), nuk jep të drejtë për ta anuluar këtë vendim, por neni 49.4 e përcakton këtë procedurë dhe ne mendojmë se ky është një vendim joligjor dhe kjo pikë duhet të anulohet edhe për arsye të tjera. Këto komisione janë themeluar në fund të vitit 2013, prandaj ne si Kuvend së pari është desh të kërkojmë raporte prej këtyre dy komisioneve, pastaj vlerësojmë punën e këtyre dy komisioneve, pastaj ta shqyrtojmë mundësinë e anulimit.

Në këtë formë si është propozuar sot është vetëm një vendim i qëllimshëm politik.

Arben Mehmeti –tendenca për ta heq këtë pikë nga rendi i punës është tendencë politike, sepse ky është një vendim i Komunës i cili është marrë më 16.10.2012 dhe unë nuk dua të hyjë në përmbajtje, sepse arsyeje për ta anuluar këtë komision ka shumë. Është kompetencë e këtij Kuvendi për të nxjerr vendime, por është kompetencë e këtij Kuvendi për t' i anuluar vendimet.

A mund dikush të thotë se për një vit kemi marrë raport të këtij komisioni e që është obligim për të dhënë raport brenda vitit.

E dyta nuk e keni respektuar Statutin e Komunës së Gjilanit, sepse pjesën më të madhe të anëtarëve të komitetit i keni dërguar me njerëz jo anëtarë të Kuvendit.

Riad Rashiti- unë nuk jam për ta mbrojtur çështjen e komisionit , por jam për ta respektuar ligjin, prandaj të jap përgjigje Zyra Ligjore se ky propozim-vendim a është i bazuar në ligj apo jo ?

Në komisione të tilla, nga Komisionet komunale kanë pas nga tre anëtarë dhe LDK-ja në të dy kompanitë e ka nga një anëtar të saj në këto komisione. Kryetarit të Komunës askush nuk mund t' ia mohojë të drejtën që ta ndërrojë anëtarin e tij në këtë Komision, ta vendos ke të dëshirojë ai, sepse LDK-ja mund t' i ketë sot dy anëtarë në këto dy komisione, sepse e ka shumicën e votave për të marrë vendime. Mirëpo ky propozim-vendim i sjell sot për t' i anuluar këto dy komisione është propozim jo ligjor. Raportimi i komisionit bëhet në fund të vitit dhe sipas ligjit raporti bëhet për çdo vit, tash jemi në muajin mars dhe ka qenë desh kjo qeverisje të kërkojë nga këto komisione t' i sjellin raportet e që do të jetë raporti i parë në muajin mars. Mirëpo kjo është çështje e juaja që ju si qeverisje që nuk keni kërkuar që këto komisione të raportojnë në këtë seancë.

Bujar Nevzadi- ne në KPF kemi kërkuar një informatë me shkrim dhe një arsyeje, por sot asnjë fjalë nuk është shkruar në letër. Ne po kërkojmë arsyeje me shkrim dhe asgjë tjetër. Ju votat i keni, por le të dihet se po bëni shkelje ligjore, por edhe kjo ngarkesë e rendit të punës është jo transparente dhe e mundimshme.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- të gjitha këto janë rekomandime të KPF-së dhe çështja e komisionit të Kosvatransit dhe Higjeinës është debatuar dhe arsyetimin e kësaj pike do ta arsyetoj drejtori për Zhvillim Ekonomik.

Avdyl Aliu- mua po më brengos dualizmi i cili është mjaft evident dhe nuk kisha dëshiruar të ketë herëve të tjera dualizëm të tillë në seancë. Disa koleg kanë qenë në KPF dhe këtu e kam vërejtjen, sepse ne nuk kemi pasur problem në KPF, atje është vendos kështu, kurse sot nuk pajtohen, kjo është brengë e imja. Po thirreni në ligj, por secila pikë e rendit të punës është e bazuar në ligj.

Riad Rashiti- pika e rendit të punës për dhënie në shfrytëzim të pronës së Komunës, besoj se është i bazuar në ligj, por i mungojnë disa të dhëna shtesë. Së pari nuk është përcaktuar koha për sa epen këto prona në shfrytëzim? Mandej ka propozime që pronat e propozuara për dhënie me qira, bien në kundërshtim me planin komunal urbanistik. Mandej duhet të bëhet definimi i saktë i pronës e cila epet në shfrytëzim etj.

Sahit Abazi – e para po e them se para se t' i dërgojmë emra për komitete njëherë duhet ta pyesim jurinë e që në këtë rast është Arbeni!

Mandej u tha se ne jemi pajtuar me këtë rend pune në KPF, ne nuk jemi pajtuar, ekzistojnë procesverbalet dhe nuk është e vërtetë se jemi pajtuar që të debatohet sot për anulimin e vendimit të komisionit të aksionarëve.

Ne kërkojmë që pika për anulimin e Komisionit të aksionarëve të shtyhet, por edhe pika tjetër për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale të shtyhet, sepse nuk ka kaluar nëpër procedura të duhura.

Sergjan Mitroviç- unë i përshëndes të gjithë dhe pajtohem me propozimin që pika 3 e rendit të punës të hiqet, me arsyetimin se na duhen ende konsultime me kryetarin e Komunës për zgjedhjen e zëvendëskryesuesit të Kuvendit për komunitete. Nën të ndryshme kam mjaft për këtë rast, por do t' i vije radha.

Gjithashtu po theksoj vështirësi të mëdha kam me teknikën e përkthimit dhe mjetet tjera të zërimit, sepse krijohet zhurmë e madhe dhe nuk është zëri i qartë dhe nuk kam mundësi për ta përcjell seancën ashtu si duhet.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- kush është që të aprovohet rendi i punës pa pikën 3

Aprovohet rendi i punës pa pikën tre me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, 7 kundër dhe 4 abstenime.

Miratimi i procesverbalit

Riad Rashiti- nuk pati vërejtje në procesverbal, por pati vërejtje në sekretari që ftesat për seancë mos të dërgohen në atë mënyrë dhe jo në këtë formë sikur ftesa për dasma. Është rregullorja e punës dhe të na bëhen ftesat ashtu si duhet!

Aprovohet procesverbali me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

2. Betimi i anëtarëve të rinj të Kuvendit

Betimin solemn e bëjnë dy anëtarë të rinj të Kuvendit: Selvete Shurdhani dhe Renan Imam.

3. Zgjedhja e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për komunitete

Gjatë debatit për aprovim të rendit të ditës, kjo pikë u hoq nga rendi i punës dhe do të propozohet për rend pune në seancën e radhës.

4. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa

a) Raporti financiar janar-dhjetor 2013-

Për shqyrtim të raportit dhe sqarime para anëtarëve të Kuvendit, kryesuesja ia bartë fjalën drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Sali Kçiku.

Sali Kçiku- buxheti i planifikuar për vitin 2013 ka qenë 18.418.682.00 €, për paga mëditje, shërbime dhe mallra, subvencione dhe shpenzime kapitale.

Buxheti është planifikuar nga granditë e përgjithshme dhe nga të hyrat vetanake, por buxheti është rritur nga mjetet vetanake për vitin 2013 dhe mjetet e bartura nga viti 2012 nga donacionet dhe participimet e qytetarëve.

I tërë ky buxhet është rritur dhe është bërë mbi 21 milion 700 mijë €.

Duke e analizuar buxhetin vërehet një keq menaxhim i buxhetit të shpenzuar gjatë vitit 2013, sepse ka shërbime të kryera pa procedura të prokurimit, shpallje të tenderëve pa zotim të mjeteve, keq menaxhimi i investimeve kapitale dhe keq menaxhimi i subvencioneve. Buxheti planifikuar është shpenzuar në vlerë prej 733 mijë e 976 €, nga burimet e ndryshme financiare.

Sipas raportit financiar shpenzimet janë 4 milion e 112 mijë €,

Mandej mbi 4 milion e 112 mijë, janë obligimet financiare në të cilat obligime bëjnë pjesë obligimet e investimeve kapitale të zhvillimit ekonomik 2 milion e 083.254 €, mbi 1 milion e 430 mijë për investime dhe mbi 1 milion e 430 mijë € për projekte.

Mirëpo janë edhe obligimet kontingjente në shumë mbi 2 milion e 903 mijë €. Këto obligime janë konteste gjyqësore të cilat janë ende të pazgjidhura, por janë si obligime aktualisht dhe varet se si do të përfundojë kontesti në gjyq?

Mandej janë edhe shpronësimet, vlerësimi i shpronësimeve për Lumin Mirusha, prej Hotel "Kristalit" deri te rruga qarkore e cila kap një shumë prej 1 milion e 960 mijë € e cila është faza e vlerësimit nga kompania e licencuar.

E kemi edhe një borxh për rrugën në Vërbicë të Zhegocit dhe totali i punëve të kryera i vlerësuar nga komisioni me datë 28.12.2011 është në obligim ndaj një kompanie 678 mijë e 898 €.. Ky ishte raporti i buxhetit në vija të trasha, por z. Kçiku i sqaroi edhe shpenzimet në detale sipas kodeve buxhetore.

Mirëpo z. Kçiku theksoi se nëse merret si total dhe nëse zgjidhen kontestet në favor të ankuesve, atëherë Komuna do të ketë një borxh, prej 9 milion e 657 mijë €.

Lutfi Haziri- ne sot po paraqesim raportin financiar, sipas detyrës zyrtare. Sipas ligjit kërkohet që raporti financiar të raportohet në çdo fund të vitit kalendarik dhe dëshiroj që edhe njëherë të sqaroj se po merrem me punë dhe zbatim të ligjit i cili nënkupton në këtë cikël përfundimin e detyrave ligjore e të cilat parashihen për vitin 2013.

Unë mendoj se debati i juaj do të na ndihmon në vendosjen e disiplinës buxhetore, vendosjen e dietës buxhetore dhe solidariteti qytetar dhe mirëkuptimit qytetar.

Zbardhja e obligimeve të Komunës përmes raportimit të rregullt që bëhet sot, kategorizimi i borxheve dhe gjithçka që është e papaguar, ajo është borxh.

Dua t'iu them se deri më dje ne gjithnjë po pranojmë edhe më shumë borxhe të tjera të cilave fatkeqësisht nuk po i vendoset pika. Ligji e mbyll këtë proces dhe numri i faturave që vjen në të ardhmen nuk ka të bëjë më me obligime të drejtpërdrejta. Vetëm ditën e djeshme na arrit një faturë të pagave prej 10 mijë eurove të punëtorëve të Kulturës e të cilët kanë marrë paga përmes subvencioneve e të cilave nuk iu është paguar tatimi në fitim. ATK-ja si autoritet tagrambledhës nuk lejon që askush që mjetet e buxhetit të mos paguhet. Është një barrë shtesë e cila nuk është faturuar këtui, por ne duhet t'ia paguajmë Administratës Tatimore obligimet. Kur u përmend kultura nëse i marrim si shembull shpenzimet ditore vetëm për ushqim edhe mujore edhe vjetore kalojnë shumë e madhe marramendëse dhe shihet qartë se më tepër është dhënë për ushqim dhe reprezentacion se sa për kulturë. Kultura ka pasur harxhime 112 mijë €, kurse mbi 500 mijë €, ka kushtuar shpenzime në ushqim. Ka fatura të ndryshme të restoranteve të reja dhe të vjetra dhe obligime të pakryera.

Unë po kërkoj që zbardhja e këtij raporti duhet të jetë mësim, sepse janë krijuar kushtet që Komuna e Gjilanit të falimentojë. Këtu u përmend disa herë pushteti, por pushtetin në Kosovë e ka PDK, kurse qeverisjen lokale e ka PDK dhe koalicioni i tij dhe nuk është pushtet, sepse ne zbatojmë ligje dhe vendime, sikur që e kemi zbatuar vendimin mbi 15% e shpenzimeve që e ka marrë qeveria me vendim. Ne iu kemi përgjigjur vendimit ligjor i kemi gjet mjetet dhe 15% i kemi ul shpenzimet e mallrave përkundër borxheve.

Ky obligim i madh dhe ky rrezik që Komunën tonë ta deçertifikojnë nga ana financiare nuk guxon të përsëritet asnjëherë. Në asnjë mënyrë nuk guxojmë të lejojmë që borxhet t' i gërryejnë institucionet dhe interesin qytetarë. Këto borxhe të nderuar anëtarë të Kuvendit dhe ju të tjerë 70% të rasteve janë borxhe të këqija e të cilat janë grumbulluar që nga viti 2010, por nuk janë borxhe të vitit 2013, por pasqyrohen si borxhe të vitit 2013.

Këto borxhe janë probleme serioze me të cilat ne sot po ballafaqohemi. Ne karshi qytetarit tonë duhet të turpërohem me këtë raport, por ne duhet ta bëjmë një prerje dhe kjo prerje po ndodh sot dhe nuk do të përsëritet më asnjëherë. Si do që ta merrni unë do të mundohem të sillem si kryetar i Komunës dhe këtu asgjë nuk do të bëj me ngjyime partiake, por një pjesë e madhe e këtij raporti do të trajtohet nëpër gjykata, sepse kryetari i Komunës as anëtarët e Kuvendit nuk e kanë rolin e gjyqësorit.

E kam të qartë se borxhi kontingjent do të shtohet, por gjykata vendos për disa fatura dhe obligime dhe për disa rregulla të shpenzimeve. Unë jam vetëm si paraqitës i këtij raporti dhe iu lus që ta ruajmë disiplinën buxhetore, sepse nuk kemi alternativë tjetër.

Mirëpo ne duhet të shpallim edhe punë, në mënyrë që të dalim nga kjo situatë depresive të cilën e ka shkaktuar menaxhimi i keq dhe shkaktimi i borxheve.

Sahit Abazi- unë e falënderoj drejtorin e financave për korrektësinë që e ka pasur lidhur me këtë raport me të cilin raport shihen, shpenzimet, harxhimet dhe investimet. E vërteta e këtij raporti është se në fund thuhet se borxhet komunale janë 4 milion e 112 mijë €.

As ne si opozitë nuk mund ta demantojmë më mirë se sa ky raport thash e thënat se Komuna ka shumë më tepër borxhe. Sa i përket borxheve kontingjente të gjitha ata që i njohin financat , këto janë borxhe e të cilat mund të kalojnë 50 vite e të mos paguhen?

Unë personalisht nuk jam avokat i askujt, por e ftoj kryetarin e Komunës i cili për cilën do pikë që mendon që është shkelje ligjore le t' i procedojë në Prokurori.

Konsideroj se nuk është absolutisht e drejtë që të maltretohet Kuvendi dhe qytetarët e Gjilanit me lloj- lloj shifre për derisa ka institucione që e zgjidhin këtë problematikë.

Të mos harrojë kryetari i Komunës se sa derisa ishte zv/kryeministër e pat bllokuar buxhetin e Komunës, kurse sot nuk ka nevojë të shes moral ! Ishte në një periudhë kryetar i Gjilanit, zotëri Xhemajl Hyseni i ndjerë të cilit ia pat bllokuar buxhetin, kryetari e din shumë mirë këtë fakt!

Raporti i saktë është ky që shkruan në letër dhe unë këtij raporti i besoj dhe çdo gjë që është jashtë këtij raporti vendosin organet gjyqësore. Edhe njëherë po e përsëris borxhi total është 4 milion e 112 mijë €. Mirëpo ne sot po i bartim edhe 330 mijë €, nga viti 2012 dhe aji 2013 dhe i tërë borxhi mbetet 2 milion e 700 mijë €.

Mirëpo ne duhet t' i sqarojmë edhe arsyet pse janë krijuar këto borxhe. Mbi 1.5 milion janë borxhe për shpronësime, mirëpo unë i kam dy rekomandime për kryetarin e Komunës të zbatohet ajo që është thënë që të shpronësohet toka për rastin e Lumit Mirusha, kurse rekomandimi i dytë është le t' i paguan këto borxhe, sepse tash e ka një rekomandim nga qeveria për ta nënshkruar vlerën e këtyre shpenzimeve ose mos ta nënshkruajë mos të del në gazetë zyrtare dhe për pasojë ne nuk i kemi borxh këto 1.5 milion. Le ta ketë problemin e lumit Mirusha kryetari, pa e zgjidh problemin e shpronësimeve. Unë mendoj se nuk mund të bëjmë projekte kapitale serioze për pa bërë shpronësime, prandaj një pjesë e mirë e këtyre borxheve ka qenë te investime kapitale, sepse ka qenë domosdoshmëri për të ndodh këto investime.

Edhe njëherë e lus kryetarin e Komunës për korrektësi, sepse po bëhen 100 ditë dhe nuk është punuar asgjë dhe ka mbetur duke mbajtur konferenca për këto borxhe të fryra.

Kryetari i Komunës e ka mashtruar opinionin duke u thirr në 8 milion borxhe, kurse sot në raport zyrtar i kemi 4 milion, prandaj për këtë dikush duhet të mbajë përgjegjësi. Kaluan 100 ditë qeverisje dhe asnjë projekt zyrtar nga kjo qeverisje nuk e kemi! Unë e them se këto 100 ditë qeverisje janë fyerje për Gjilanin, prandaj kërkoj që ta merr veten dhe të punojë në dobi dhe interesa të qytetarëve të qytetit me rrethinë të Gjilanit.

Lutfi Haziri- për shkak të respektit nuk e kam ndërmend të hyjë në dialog me askënd! Autoriteti absolut mbi mua është Asambleja Komunale, por sot nuk po flasim për plane për buxhet 2014, as për 100 ditshin, sepse ai 100 ditësh do të vijë shpejtë.

Mirëpo mos të mendojë askush se ta marrë modelin e punës së qeverisjes së kaluar të shpenzimeve. Kryetari i grupit kuvendar të PDK-së po insiston të na i bartë neve modelin e njëjtë të shpenzimeve. Mirëpo ne këtu kemi dallime dhe do të kemi dallime sot e 100 vjet në modelin qeverisës. Mos të fshehët z. Abazi pas milionëve të harxhuar në ushqim.

Janë 9 milion e 600 mijë € dhe çdo faturë e papaguar është borxh, nuk ka fjalë tjetër që e deshifron këtë pos borxh. Ka pasur rekomandime të auditorëve dhe është këtu Sherafedin Latifi i cili çdo vjet ka bërë raport dhe ka rekomanduar që keq janë duke u bërë shpenzimet. Nuk është që nuk e kanë parë, sepse janë pasqyruar në dokumente, por zvogëlimi i borxhit nuk të bën borxhli më të vogël. Nëse thua nuk i kam 8 milion, por i kam 4 dhe tash jam borxhli më i mirë, sepse borxhi është borxh. Shumë seriozisht vështirësia e jonë në qeverisje është shumë e madhe. Mos u mundoni t' i ikni vitit 2013, duke i minimizuar borxhet, por problemi qëndron aty se nuk mund t' i paguajmë faturat.

Zyra e Kryetarit të Komunës për një vjet i ka shkaktuar borxhe pa shpenzime të tjera mbi 272 mijë € vetëm për ushqim dhe pije(në vijim i lexon emrat e hoteleve dhe restauranteve prej të cilave kanë ardhur faturat). Këto janë borxhe të pa paguara, të paguarat janë në tjetër kategori. Ne i kemi kategorizuar tri nivele të borxheve me të cilat merremi tash. Mandej në muajin e parë me çfarë borxhe jemi marrë, në muajin e dytë dhe në të tretin, kurse sot kalojmë në kategorinë e borxheve kontingjente për t' i paguar. Modeli i dytë janë shërbimet kulturore për të cilat Komuna i ka borxh 55 mijë €. I tërë ky është borxh i keq, por të cilin duhet ta paguajmë.

Bujar Nevzadi- e lus kryetarin e Komunës që t' ia fillojë me argumente, le të fillojë me letra, le t' i lejë më fjalët dhe llafet. Ne njihemi në një periudhë 22 vjeçare dhe kryetari gjithmonë ka thënë llafe në hava! Në qeverisjen para neve i ka pasur dy zyrtarë si të ndjerin Xhemajl Hyseni i cili ka udhëheq Komunën dhe kryeshefin Ekzekutiv Enver Muja, kurse kryetari aktual është marrë me vizita në shtete të jashtme.

Ka qeveris një qeveri e PDK-së për 8 vjet dhe qytetari është mësuar me mënyrë tjetër të qeverisjes dhe ne nuk po themi nuk kemi harxhuar, por a është thënie borxhliu është borxhli si 4 milion si 8 milion! A e din çka është milioni kryetari i Komunës? Janë 40 faqe raport financiar dhe aty qartë shkruan 4 milion 112 mijë euro dhe jo 9 milion!

Mirëpo edhe minus 370 mijë mjete të bartura, mbesin 3 milion e 700 mijë. Sillni letrat kujt i kemi borxh? Pse nuk i keni sjell këtu? Zyrtarisht e keni bërë këtë raport dhe zyrtarisht Komuna e Gjilanit i ka 3 milion e 700 mijë €, për vitin fiskal 2013.

Z. kryetar po thirret në ligj, kurse drejtorit të Financave ia dha fjalën për pa na njoftuar se e ke emëruar drejtor! Kjo është shkelje ligjore, kurse shkelja e dytë ligjore është se ju keni qenë në ekzekutiv lokal dhe e kemi miratuar rendin e punës në KPF dhe nuk iu ke përmbajtur rendit të ditës! Ju e keni nis me shkelje ligjore, prandaj kërkoj që t' i kthehesh argumenteve dhe letrave ! Dërgojë në gjykata dhe lëri më lafet!

Riad Rashiti- pos shihet se kryetari ka pushuar gjatë dhe ka kondicion, por tash në foltore të KK-së i drejtohet KK-së i drejtohet qytetarëve të Gjilanit dhe e paraqet gjendjen e Komunës si në Krime, është pa presedan ! Unë nuk po i përsëris fjalët e kolegëve të mi, por kërkoj që të jemi më real, të jemi më të qartë në atë që e themi.

Mandej e di që drejtori aktual është hera e parë që del me raport dhe e di që i mungon përvoja, por ka pasur zyrtarët e tjerë dhe ka pasur mundësi më hollësisht të flas edhe për zhvillimet e tjera financiare të cilat kanë ndodhur në Komunë të Gjilanit.

Kryetari nuk tha asgjë për investimet që janë bërë në vitin 2013, nuk u përmenden sa projekte janë realizuar, sa janë realizuar të hyra nga buxheti komunal, sa ka pasur grande ? Nuk u përmenden 2.5 milion € që Qeveria e Kosovës i ka dhënë për t' i përkrah projektet e Komunës, por filloi me ato shpenzime dreka, darka e të cilat pohime nuk qëndrojnë absolutisht. Kërkoj që gjërat të paraqiten të detajuara dhe të mos shpif, para Kuvendit, sepse edhe kjo është vepër për të cilën mund të përgjigjet.

Unë po i them edhe njëherë që mos të shpif me shifra, sepse edhe më tmerrshëm thotë se miliona janë shpenzuar për ushqim, kjo është e turpshme dhe skandaloze. Le t' i paraqet ku janë? Unë këtu po shoh shifrat, por nuk do t' i lexojë të gjitha, por dreka zyrtare mos i paraqitni ato ushqime të cilat bëhen për çerdhe të fëmijëve! Mos i paraqitni dreka zyrtare gjërat ushqimore të cilat i marrin qindra familje me gjendje të rëndë sociale!

Ato nuk janë shpenzime zyrtare të cilat i ka shpenzuar kryetari i Komunës, kurse dihet se "Flaka e Janarit" mbahet çdo vit, por nuk thuhet asnjë fjalë se sa mjete janë shpenzuar?

Ta dimë krahasimin sa ju keni shpenzuar këtë vit dhe sa në vitin e kaluar për "Flakë të Janarit". Pse nuk po na e pini një shembull të tillë?

Për borxhet e tjera për të cilat u debatua u paraqiten borxhe të shpikura nga drejtori financiar gjëja për fushatë parazgjedhore. Flitet për shpenzime, por të pa dokumentuara, kjo është një akuzë e rëndë. Mirëpo ky është një raport financiar të cilin ju e keni bërë dhe këtë shihet se është një borxh prej 4 milion e 112 mijë €, kurse prej 377 mijë i keni kesh (në llogari të bankave), ato janë mjete të bartura që ju sot i keni dhe ne i kemi krijuar borxhet i kemi krijuar edhe ato 377 mijë €.

Gjithashtu prej kësaj shume janë 1 milion e 340 mijë obligime për shpronësime të Lumit Mirusha. Këto do të rriten këto borxhe. Prej 1 milion e 340 mijë, 600 mijë janë para të këtij viti të planifikuara me buxhetin komunal. Me ligj obligimet për shpronësime nuk është e obliguar Komuna t' i kryejë menjëherë edhe pse krijohen obligimet, por me ligj ato mjete për dy vite duhet të paguhet, prandaj këto mjete janë të viti 2013, 600 mijë janë para të planifikuara me këtë buxhet për shpronësime.

Në vazhdim të fjalës së tij z. Rashiti i përmendi projektet të cilat janë realizuar gjatë vitit 2013 e të cilat kanë krijuar shpenzime.

Te detyrimet kontingjente është mirë që edhe drejtori ta lexojë dhe ta kuptojë se çka janë detyrimet kontingjente?

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – ju lus që ta respektoni rregulloren e punës së Kuvendit dhe për të njëjtën çështje mos ta marrin fjalën shumë anëtarë të Kuvendit. Të merreni vesh në gupet parlamentare dhe për një pikë të rendit të punës mos të përsëriten gjërat.

Zijadin Maliqi- unë pas analizave që i kam bërë në raport, kam konstatuar se raporti teknikisht është i përgatitur mirë, por menaxhimi i mjeteve financiare gjatë vitit 2013 është shumë i dobët, sepse kemi lëshime dhe shpenzime të mëdha.

Të hyrat vetanake janë realizuar diku afër 91% ose 9% më pak se sa janë të planifikuara ose në mjete financiare prej 311 mijë € më pak se sa të planifikuarat.

Kemi laramani te të hyrat, diku kemi mbi ato të planifikuarat, kurse diku ka ngecje dhe në përfundim del ajo të cilën e theksova.

Gjatë analizës që i kam bërë këtij raporti mendoj se menaxhimi i këtij buxheti gjatë vitit 2013, mendoj se nuk është bërë në mënyrë të mirë! Kemi shpenzime të mëdha, shkelje të mëdha.

Kur e shikojmë pasqyrën e shpenzimeve të planifikuara dhe të shpenzuara del se deri diku janë përafërsisht në kuadër të normales. Mirëpo kur i marrim parasysh edhe obligimet të cilat janë krijuar gjatë vitit 2013 për shpenzime të krijuara, por të papaguara, atëherë na del krejt një gjendje tjetër, na del se shpenzimet janë shumë më të mëdha se sa janë planifikuar. Shpenzimet janë 35% më të mëdha se ato të planifikuarat.

Nëpër të gjitha kategoritë të pagat, mallrat dhe shërbimet, subvencionet, investimet kapitale del se çdo gjë është në rregull dhe në kuadër të planifikuarës, mirëpo kur e marrim edhe pasqyrën e fundit ku shihen obligimet e paraqitura del se kemi shpenzime shumë të mëdha. Shpenzime të krijuara dhe të papaguara janë 4 milion e 112 mijë € e të cilat janë të nxjerra nga drejtoria në bazë të faturave e të cilat janë dorëzuar deri më 31.12.2013. Mirëpo janë edhe shpenzimet kontingjente e të cilat u sqaruan se çka janë, por kryesisht janë të krijuara për Lumin Mirusha. Mirëpo shuma tjetër mbi 670 mijë €, nuk e kam të qartë pse ka hyrë te shpenzimet kontingjente, kur aty thuhet për punë të kryera? Në bazë të këtyre të dhënave dhe plus 678 mijë €, del se mbi 7 milion janë borxhe e që është shumë. Vetëm te mallrat dhe shërbimet e kam vërejt se e kemi një tejkalim prej 16% të mjeteve të planifikuara.

Po të hyjmë në analitikë dhe t' i analizojmë në mënyrë analitike shpenzimet nëpër disa kode buxhetore është për t' u habitur. Te drekat zyrtare janë mbi 168 mijë € janë shpenzime të paguara, mbi 145 mijë € janë shpenzime të krijuara, por të papaguara dhe gjithsejtë për vitin 2013 janë mbi 314 mijë €, e që bie diku për ditë pune 1 mijë e 200 €, e që nuk kanë hyrë ushqimi për çerdhe, por vetëm për dreka zyrtare për pa i heq festat dhe pushimin vjetor.

Sa i përket obligimeve, Riadi i solli gati në zero, por nuk bëhet raporti ashtu, sepse mjetet që barten nga viti në vit nuk llogariten ashtu. Këtu janë 4 milion e 112 mijë €, në bazë të faturave që janë dorëzuar në drejtori deri më 31.12.2013. detyrimet kontingjente po përsëris se janë detyrime që janë proceduar në gjyq, por drejtoria është e obliguar t' i paraqes në raport. Është Ligji mbi menaxhimin e financave, është raporti financiar mbi buxhetin neni 46/1 pika 4.i, të cilin nen z. Maliqi e citon.

Unë e kam një pasqyrë të këtyre shpenzimeve prej tri faqeve (detyrimeve kontingjente) e që ndonjëherë prej tyre mund ta fitojë Avokati i Komunës, por ajo që shkon në favor të palës, nuk mbetet kjo që është, por rritet, sepse i shtohen të gjitha shpenzimet e tjera si kamata etj. Unë nuk llogaris obligim vlerësimin e fazës së dytë të Lumit Mirusha, sepse ajo është vetëm vlerësim dhe nuk dihet se kur realizohet.

Shuma prej 678 mijë €, për një rrugë të Malësi të Zhëgocit, sipas drejtorit punë kryesi po i kërkon ato para dhe ekziston një raport i një komisioni i cili ka bërë vlerësimin e asaj pune. Nëse vërtetë është bërë ashtu është një shkelje e rëndë, sepse janë kryer punët pa procedura të prokurimit, pa kontratë dhe obligime tjera është shkelje e rëndë. Unë e llogarisë se Komuna nuk ka obligim ndaj atij punë kryesi, sepse nuk ka kontratë dhe nuk ka dokumentacion tjetër të nevojshëm.

Në bazë të të gjitha të dhënave e lus udhëheqjen e re që të merr mësim në këto gjëra dhe të punojë më ndryshe, sepse kjo është para e qytetarëve.

Unë nuk jam për ta aprovuar këtë raport, por jam vetëm për ta konstatuar, sepse aprovimi do të thotë që po pajtohem me të gjitha ato të këqija që janë në këtë raport.

Arben Mehmeti- u thanë shumë gjëra për këtë raport, por edhe kemi folur jashtëzakonisht shumë në të kaluarën dhe janë faktet e argumentuara dhe askush nuk mund ta vejë në dyshim

keq menaxhimin e parasë në vitin 2013. Ky është raport zyrtar i cili ka dal nga zyrat e Komunës, por e kemi edhe raportin e Auditorit Gjeneral i cili ka dhënë të shumta për keq menaxhim. Nuk kemi shumë pse të merremi me këtë raport, sepse ky nuk është raport i joni, por është raport i ish qeverisë komunale.

Unë mendoj se ky raport duhet të votohet në Kuvend si raport i opozitës në këtë rast, sepse është shpenzim i atyre që kanë qenë në qeverisje, por ne si LDK nuk e votojmë, sepse nuk e kemi menaxhuar këtë raport.

U përmenden shpenzimet ose borxhet kontingjente e të cilat duhet t' i dërgohen anëtarëve të Kuvendit, kurse ato 678 mijë € për rrugën në Malësi të Zhegocit, ato nuk janë për neve, por duhet të dërgohen në Prokurori. Gjithashtu është mirë që drejtori i Financave të na tregojë se kush është në atë komisioni, kush e ka emëruar atë komision ?

Riad Rashiti- unë po e paraqes realitetin dhe askush nuk mohoi borxhin zyrtar prej 4 milion e 112 mijë €. Nga këto borxhe shpronësimet llogariten se paguhen për dy vite.

Janë 1 milion e 840 mijë € për të cilat ka marrë obligim Qeveria e Kosovës për t' i kryer obligimet. Ne nuk mund t' i faturojmë obligimet Qeverisë së Kosovës, sepse ajo i lëshon mjetet. Janë 1 milion e 340 mijë për shpronësime, 377 mijë € janë të vitit të kaluar dhe si është llogaritur borxhi, llogariten edhe të hyrat. Nga shitja e hapësirave të PPP-së janë 1 milion e 600 mijë €, dhe krejt mbetin borxhe reale 300 mijë € dhe nuk ka më tepër.

Zijadin Maliqi- unë nuk dua të hyjë në polemikë me Riadin, sepse unë i shpjegova i shpjegova si bëhet bartja prej vitit në vit, por gjithmonë shpronësimet janë në bazë të faturave për Lumin Mirusha. Lumi do të punohet edhe më tutje, mjetet që janë paraparë me buxhetin e vitit 2014 janë për punë të mëtejme. Ai borxh është krijuar dhe nuk mund të krijojmë tash minus me këto mjete, sepse ato janë krijuar.

Edhe zotimet kontingjente edhe ato janë detyrim kontingjent dhe unë e di shumë mirë rastin e këtyre mjeteve, për një rrugë afër Fabrikës së Radiatorëve, pronari nuk është pajtuar me vlerësim dhe ka vendos të bëjë padi në gjykatë. Këto borxhe edhe mund të dyfishohen, por edhe mund ndonjë edhe të bie në tërësi. Për atë janë detyrime kontingjente, por detyrimet kontingjente janë të parapara të përfshihen në raport me Ligjin mbi financat.

Fehmi Sylejmani-ne mendojmë se jemi duke humbur kohë shumë, sepse tre mujsori i këtij viti po përfundon dhe ¼ e viti ka kaluar, prandaj duhet më tepër të merremi me planifikimin e këtij viti. Ne edhe në seancën e kaluar kemi thënë që të formohet një auditim që ta verifikojë saktë sa është borxhi, kujt i ka borxh Komuna dhe për çfarë arsyeje është ky borxh dhe a ka përfunduar ajo punë për të cilin është krijuar borxhi?

Në bazë të kësaj të dalim me një raport apo vendim zyrtar dhe mos të humbim kohë në këtë mënyrë aq kohë të gjatë, por të merremi me punë dhe planifikime të vitit 2014.

Sali Kçiku- sa i përket obligimeve kontingjente unë isha shumë i qartë dhe po theksoj se për obligime kontingjente e kam listën prej 126 njerëzve të cilët kanë bërë konteste të ndryshme, si për paga të pensioneve, shpronësimeve etj dhe e tërë kjo listë është te Avokati i Komunës. Sa i përket obligimit për rrugën e Zhegocit është vendimi i kryetarit për emërimin e Komisioni prej tre anëtarëve: Merita Canaj -kryetare komisionit, Hamdi Ismajli dhe Agim Hoxha anëtarë. Ky komision e ka bërë vlerësimin e punës me paramasa dhe ka bërë raport për pranim teknik dhe vlere është mbi 678 mijë €. Në zyrën time e posedoj komplet dokumentacionin për çdo pozicion që është kryer në atë lokacion.

Sa i përket Lumit Mirusha e thash qartë është bërë vlerësim, por nëse duam të punojmë edhe këtë vit, ne duhet ta bëjmë edhe kompensimin e shpronësimeve.

Sahit Abazi- e mira këtij debati është se nuk ka më fshehje për mos punë dhe nuk krijohen borxhet pa punë. E dyta e lus kryetarin dhe kushdo që merret me këtë punë, ndiqni procedurat në organet përkatëse dhe mos e dezinformoni publikun për gjëra të cilat nuk ekzistojnë!

Avdyl Aliu- së pari një këshill: “para se të shpenzosh fito”! Po t’i përmbahemi kësaj edhe si familje punët do të ishin më mirë, kurse për institucionin të mos flasim.

Më 2009 në këtë Kuvend ne kemi qenë opozitë, një kolegj i joni e pat thënë se është mirë që drejtorët të vijnë elegantë dhe me kravatë në seanca. Mirëpo një tjetër kolegj u përgjigj se nuk është me rëndësi se si vishemi, por me rëndësi është për ta pasur fytyrën e pastër!

Unë mendoj se ky raport e paraqet fytyrën e komplet qeverisë dhe shumë shkurt po i paraqes vetëm dy çështje: te drekat zyrtare është një vendim i kryetarit i cili e ka formuar një komision i cili duhet t’i verifikojë të gjitha faturat e kontestuar ose të papaguara, të bëjë verifikimin e tyre dhe të sjell raport përfundimtar për gjendjen e tyre. Vendimi është marrë në maj të vitit 2013 dhe janë verifikuar faturat e Hotel “Kristali”, “Bujana” dhe “Luli” për tërë vitet 2008, 2009 dhe deri më 2013. Shuma e këtyre borxheve është mbi 73 mijë €, dhe po garantoj se këto nuk janë për ushqim të fëmijëve në çerdhe, por janë dreka zyrtare dhe këto janë fatura që janë harruar. Si mund të harrohet një faturë 5 vjet, por edhe kanë humbur në tërësi.

Në fund të raportit thuhet se komisioni ka hasur në vështirësi, sepse edhe pse faturat kanë qenë të nënshkruara nga drejtorët e drejtorive, nuk janë dorëzuar te zyrtarët financiar, mandej thuhet sa kanë has edhe në aso fatura të cilat janë paguar njëherë, por përsëri janë faturuar.

E dyta pagesat për përfitues individual për të cilin rast e kam një emërore shumë të gjatë për këta përfitues dhe është për keqardhje se çka ka aty dhe çfarë emra ka. Është një qytetarë nga Velekica i sëmurë nga kanceri të cilit nuk iu ka dhënë asnjë ndihmë, por po të analizohet ajo listë se kujt iu është ndihmuar është për t’u habitur.

Bujar Nevzadi-së pari i lus që mos të shesin moral, ata që nuk kanë moral! Unë e kam thënë dhe po e them se jam i gatshëm të ballafaqohem me secilin për gjithçka? Asgjë nuk ka të fshehur të gjitha i dërgoni në gjykatë. Ne jemi krenar për punën që e kemi bërë për gjashtë vjet dhe mund të ballafaqohemi për gjithçka.

E dyta për drejtorin e Financave i cili e tha se i ka obligimet kontingjente, por ne e kemi thënë edhe në komitet, se ne nuk kemi asgjë dhe nuk e dimë se çka ka drejtori!

Të na i sillni neve këtu dhe pa fatura asgjë nuk mund të quhet obligim, prandaj gjeni në cilin raport financiar është paraqitur obligimi ndaj “Bejta Comercit”?

Riad Rashiti – u përmend një vendim i kryetarit të Komunës i cili e ka themeluar një komision për vlerësimin e punëve të kryera, prandaj unë mendoj se edhe kryetari aktual i Komunës dhe drejtorit përkatëse duhet t’i vlerësojnë gjithnjë investimet për secilin rast, qoftë private, qoftë dhurues, qoftë qeveri ato duhet të vlerësohen.

Mirëpo tjetër është vlerësimi i investimeve dhe tjetër është krijimi i obligimeve dhe fatura prej faturës. Kjo është një dallim shumë i madh.

Është mirë t’i bëhet edhe një pyetje këshilltarëve të LDK-së sa herë kanë marrë pjesë në dreka zyrtare të cilat po përmenden aq shumë?

Abdyl Aliu- u përgjigj në pyetjen e fundit të z. Rashti dhe sipas një parallogarie del se ka qenë në disa dreka zyrtare me bashkë partiakët e tij e cila shumë nuk arrin vlerën më shumë se 4200 €.

Nuk pati debatues të tjerë dhe raporti nuk hodh në votim, por vetëm u debatua, kurse kryesuesja kërkon që anëtarët e Kuvendit të shkojnë 10 minuta në pushim.

- b.** Propozim rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01.nr.16-10498 (30.01.2013)

Pas pushimit prej 10 minutave, kryesuesja e Kuvendit e hapi seancën dhe kërkoi mirëkuptim nga anëtarët e Kuvendit që ta respektojnë Rregulloren e punës së Kuvendit. Shefat e grupeve mund të debatojnë jo më gjatë se 15 minuta, anëtarët deri në 7 minuta, kurse replika 2 minuta.

Në vijim kryesuesja kërkon që për pikën e “ b” të rendit të punës arsyetimin ta jep Zyra Ligjore.

Hevzi Matoshi- z. Matoshi e bërë arsyetimin e ndryshimit dhe plotësimit të kësaj rregulloreje duke u mbështetur në ligjet bazike të Qeverisë së Kosovës të cilin arsyetim anëtarët e Kuvendit e kanë së bashku me materialin tjetër për këtë seancë.

Sahit Abazi – për këtë pikë në emër të grupit të PDK-së fjalën do ta merr z. Riad Rashiti.

Riad Rashiti- kjo rregullore paraqitet sot para neve për ta zbatuar ligjin, por kjo rregullore për plotësim dhe ndryshim po paraqitet me vonesë të konsiderueshme para anëtarëve të Kuvendit. U tha se kjo vonesë është bërë për shkak se ka qenë vit zgjedhor, por kjo nuk qëndron, sepse në këtë kemi pasur mundësi që ta aprovojmë në dy seancat e mëparshme.

Së dyti kjo rregullore nuk ka kaluar nëpër komitete përkatëse si ai për Zhvillim Ekonomik dhe komitetet tjera me përjashtim në KPF.

Së treti propozimet të cilat janë paraqitur për ndryshim në këtë rregullore janë në dëm të qytetarëve, sepse ka ngritje të shërbimeve, ngritje të taksave të bizneseve etj.

Në shumë shërbime ka rritje të taksave 100% deri në 150%. Ne i kemi analizuar të gjitha ndryshimet e propozuara nga ana e kryetarit të Komunës dhe kemi vërejtur se ka shumë ndryshime të cilat nuk e kanë për qëllim as avancimin, por as cilësinë e shërbimeve për qytetarët dhe taksapaguesit e Gjilanit. Ne nuk e kemi të qartë pse janë bërë këto ngritje, kurse dimë se në vitet e fundit qeverisja e PDK-së, vazhdimisht ka bërë ulje të taksave, kurse në vitin 2012 i kemi hequr në tërësi taksat komunale për bizneset për ato prodhuese dhe ato të rehat. Në vitin 2013 i kemi anuluar një numër të madh të taksave, kurse sot këtu janë sjell disa propozime me të cilat disa biznese ngarkohen me taksa dhe tarifa të reja.

Ne nuk e kemi të qartë pse po ndodh kjo rritje e taksave, kurse gjatë fushatës elektorale është thënë se do të bëhet lirimi dhe heqja e taksave për bizneset.

Mirëpo rritje të tillë ka edhe në Administratën e Përgjithshme e të cilat z. Rashiti i numëron se ku ka ngritje deri në 10 herë më shumë.

Unë i propozoj anëtarëve të Kuvendit që kjo rregullore të mos miratohet kështu si është për arsyeje të cilat i thash dhe kishte qenë mirë që të zbatohet rregullorja e cila është në fuqi, do të thotë ajo e viti 2013.

Avdyl Aliu- ne e kemi rregulloren e vjetër, kurse sot e kemi këtë rregullore për debat për të bërë plotësime dhe ndryshime. Mirëpo në emër të grupit të anëtarëve të LDK-së ne i kemi bërë gati propozimet tona të cilat propozime do t' i demantojnë ato që u thanë tash, por edhe ato që janë thanë në mediet e shkruara dhe elektronike.

Në vijim të fjalës së tij z. Aliu i propozoi disa plotësime dhe ndryshime të cilat propozime po i evidentojmë sipas radhës.

Neni 3

Pika 1.1. Nga kjo pikë të hiqet certifikata e vdekjes dmth. të shkruhet paragraf në veti dhe të mos ketë pagesë fare për këtë sepse kur është në gjendje komuna të paguaj tërë procesin e varrimit në rast të vdekjes atëherë është logjike që edhe certifikatën ta lëshoj pa pagesë.

Pika 1.10. Lëshimi I certifikatës mbi identitetin të hiqet krejt sepse në kushtet kur sot qytetarët pajisen me certifikatë të lindjes edhe me letërnjoftim , kjo del e panevojshme

Pika 1.20 . Vërtetimi identik me origjinalin të mbetet pagesa 1 euro pavarësisht sa faqe janë dmth për një dokument 3 euro, rrjedhimisht pika 1.21 të fshihet krejt.

Pika 1.24. Gjetja –sigurimi i dokumenteve në arkivin e drejtorisë të jetë pa pagesë

Pika 1.27 Kërkesa për fitim e shtetësisë 5 euro , dhe pika 1.28 kërkesa për lirim nga shtetësia 10 euro , që të dyja këto shërbime të kryhen pa pagesë për arsye se sipas UA 17/2009 për procedurën e fitimit dhe të humbjes së shtetësisë është e përcaktuar taksa administrative prej 150 euro për secili rast., prandaj komuna nuk duhet të kërkoj pagesë tjetër.

Neni 4

Pika 2.7 Pikat e bankave brenda territorit të Komunës të bien nga 400 në 300

Pika 2.11 Të shndërrohet në dy pika të veçanta : dhe të jetë për hipermarkete dhe supermarket 200-300 m² të jetë 500.00 euro dhe tjetra pikë për hipermarkete dhe supermarket mbi 300 m² të jetë 800.00 euro

Pika 2.13 Bingot, bastoret dhe lojërat e fatit nga 1.000,00 euro te behet 2.000,00

Pika 2.14 Kazinot nga 1.500,00 euro sa ka qen te behet 3.000,00 euro

Neni 5

Pika 3.18 Vendosija e reklamave (muraleve) në fasada –muret e ndërtesave të zvogëlohet nga 50 në 25 euro ,

Pika 3.32 Leja për hyrje ditore në qytet për transportimin e materialit dhe , beton dhe materialit tjetër , propozojmë të zvogëlohen për 50% dmth

a) nga 20 në 10 ,në

b) nga 16 në 8 dhe

c) nga 12 në 6 euro

Pika 3.34

d) Parkingjet e rezervuara të komunës rreth objekteve të banimit kolektiv për persona fizik – nga 100 në 70 euro/ vit dhe

c) Parkingjet e rezervuara të komunës rreth objekteve të banimit kolektiv për persona juridik – nga 200 në 170 euro/vit.

Pika 3.40 Taksa për automjete motorike të zvogëlohet :

- a) për automjete deri 125 ccm nga 5 euro në 2 euro
- b) për automjete 125 ccm deri në 3500 ccm nga 10 në 5 euro
- c) për automjete mbi 3500 ccm dhe taksi-nga 20 në 10 euro

kjo për arsye se ligji mbi financat e pushtetit lokal nuk I obligon komunat për të vendosur një takes të tillë, gjithashtu edhe për faktin se përdoruesi I automjetit paguan një taksë të konsiderueshme në organet e nivelit qendrorë.

Pika 3.44 Shtrirja e rrjetit kabllorë (ajrorë) të internetit të zbritet nga 1 në 0.50 euro/m'

Pika 3.47 Oferta e shitblerjes së banesës , propozojmë të hiqet kjo procedurë pasi që nuk ka bazë ligjore, nuk është e qartë se çfarë qëllimi përmbushë kjo procedurë.

Neni 7

Pika 5.91 Vërtetim për humbjen e shtetësisë

Pika 5.92 Vërtetim për fitimin e shtetësisë , dhe

Pika 5.94 Vërtetim që nuk është shfrytëzues I ndihmave sociale

(departamentet brenda komunës kanë informacione brenda për brenda për këtë)

Neni 8

Pika 6.2 Vërtetimi se një subjekt fizik merret apo është marrë me aktivitete bujqësore , propozojmë që të eliminohet kjo për arsye se kjo nuk ka bazë ligjore dhe se komuna nuk posedon një databazë për fermerë . Ministria e Bujqësisë e mban një databazë të tillë.

Neni 10

Pika 8.5 Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike 0.5 deri në 1.00 ha nga 100 euro të bie në 70 euro

Pika 8.6 Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike 1deri ne 5 ha nga 150 euro të bie në 120 euro

Pika 8.7 Ndarja e parcelës në pjesë të përcaktuara më parë nga 80 ne 50 euro

Pika 8.8 Ndarja në më tepër se dy pjesë të përcaktuara më parë – për çdo pjesë na 40 në 30 euro

Pika 8.95 Kërkesa për korrigjimin e të dhënave personale të titullarëve pronësorë në regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme - pagesa prej 5 eurove sa ka qen deri tani të hiqet dhe kjo të bëhet pa pagesë për arsye se gabimi nuk është bërë nga pala.

Pika 8.96 Kërkesë për vlerësimin e pasurisë për trashëgimlënësin nga 10 euro të zbritet në 5 euro

Pika 8.97 Oferta për tokë dhe shtëpi që deri tani ka qen 5 euro tani propozojmë që kjo të zbritet në 3 euro

Të gjitha këto propozime për zbritje sponsorizohen nga LDK-ja dhe partnerët e sajë me qëllimin që mbretëron një gjendje kaotike ka shumë problem pronësore të pazgjidhura dhe me tendencë të rritjes së këtyre problemeve , andaj dëshirojmë që me këto zbritje dhe me këto lehtësira të inkurajojmë qytetarët e komunës së Gjilanit që siç thotë populli “një sahat e më

parë “ të fillojnë që ti drejtojnë punët në lidhje me palujtshmëritë çka do qofshin ato shtëpi apo tokë dhe mos ti bartin këto problem edhe te gjeneratat tjera.

Në këtë kontest në emër të GK të LDK-së , dhe në emër të gjitha grupimeve politike ne Kuvend kërkoj edhe nga drejtori I DGJKP që të bëjë gjithçka që është e duhur që punëtorët e kësaj drejtorie le ti shërbejnë qytetarët si është më së miri dhe letë ju kryejnë punë mirë sepse edhe kjo ka ndikim po them edhe një here në inkurajimin e qytetarëve që ti kryejnë këto punë.

Nevzad Isufi – shumë propozime që janë bërë këto, janë bërë edhe në KPF dhe unë jam i kënaqur që së paku disa nga propozimet janë rishikuar, por pajtohem me atë se është një propozim dhe ndryshim i vonuar i kësaj rregulloreje. E mira e kësaj do të ishte që trupat profesionale nëpër drejtori duke u bazuar në punën e përditshme me qytetarë të marrin edhe propozime prej tyre dhe ta kemi parasysh edhe gjendjen sociale të tyre.

Ne parimisht nuk e përkrahim asnjë ngritje të taksave dhe tarifave dhe më vejnë mirë që kolegu Avdyli e ka pranuar një propozim tonin i cili ka të bëjë me aktvdekjen i cili ka qenë çmim i lartë, por tash është propozuar të hiqet kjo taksë. Gjithashtu pajtohem edhe me një propozim i cili është bërë për kamionët transportues privat që të hiqet tarifa ose të ulet në minimum.

Ne kemi dhënë vërejtje edhe te neni 5 pika 1 te ndryshimi i trotuarit, para objektit të banimit lokalit për persona fizik ka qenë 10 € të bëhet 5 €, sepse më mirë qytetarët të paguajnë një shumë simbolike se sa këtë ta bëjnë ilegalisht dhe ne nuk përfitojmë asgjë.

Për objektet e përkohshme komunale kiosqet, do të thotë qiraja për m² është 10 €, e që mendojmë se është në rregull, por këto objekte të përkohshme i paguajnë një shumë edhe një kompanie prej 100 €, prandaj ne mendojmë se është një ngarkesë dhe për këtë arsyeje ne kërkojmë që të shikohet kontrata me “Elita grupën” dhe të hiqet ajo 100 € dhe të mbetet vetëm taksa prej 10 €.

Riad Rashiti-z. Avdyli i dha disa propozime dhe taksat tek bankat theksoi se ka ulje dhe u arsyetua për këtë propozim, por dihet se bankat qëndrojnë shumë mirë financiarisht, kurse në anën tjetër janë ngarkuar bizneset dhe për këtë kërkoj sqarim pse janë ngarkuar supermarketet kur ne vitin e kaluar i kemi liruar të gjitha me përjashtim të atyre që kanë shtrirje nacionale. Me këtë rregullore po ngarkohen bizneset të cilat janë të Gjilanit, kurse ne kemi desh që ta bëjmë një lehtësim për këto biznese, sepse ardhja e kompanive të mëdha ka ndikuar negativisht në punën e tyre. Unë kërkoj që edhe njëherë këto taksa të shqyrtohen, sepse gjatë fushatës është premtuar zbritje e taksave, por sot po ndodh e kundërta.

Propozimet e shefit të grupit kuvendar të LDK-së ka qenë desh të bëhen në KPF, sepse duhet zbatuar procedurat për secilin propozim-vendim.

Avdyli Aliu- këto propozime do të publikohen edhe në faqen zyrtare edhe rregullorja e vjetër dhe e reja për ta vlerësuar qytetarët a ka pasur ngritje apo zbritje të taksave.

Hevzi Matoshi- unë po i jap disa sqarime ligjore dhe fillimisht dihet pse nuk është aprovuar deri më tash kjo rregullore (procesi zgjedhor). Mirëpo ne në muajin nëntor i kemi filluar procedurat paraprake për plotësime dhe ndryshime. Nuk kemi të bëjmë me një rregullore të re, por kemi të bëjmë me një rregullore e cila duhet të plotësohet dhe ndryshohet. U tha se nuk ka kaluar në komitetet përkatëse, mirëpo nëse e shikoni nenin 52 të LVL-së shihet mirë se cilat janë përgjegjësitë. Kjo ka kaluar në KPF dhe obligim ligjor është që të aprovohet në Kuvend.

Në vijim të fjalës së tij z. Matoshi dha edhe sqarime të tjera ligjore për këtë rregullore.

Riad Rashiti- unë pajtohem me sqarimet e zyrtarit ligjor, por kryetari ka të drejtë të themeloj komisionin për ulje të tatimit në pronë.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja e Kuvendit, propozon që të aprovohet ky propozim- ndryshim i kësaj rregullore me vërejtjet që i dha z. Avdyl Aliu.

Aprovohet pika “B” e rendit të punës: Propozim rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale, 01.nr.16-10498 (30.01.2013), me plotësimet dhe ndryshimet të cilat i propozoi shefi i grupit të LDK-së z. Avdyl Aliu me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, 6 ishin kundër , kurse 4 abstenime.

C Propozim vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2012 dhe 2013 në vitin fiskal 2014

Sali Kçiku- ju e keni materialin e seancës dhe lidhur me këtë pikë është theksuar se është fjala për mjetet që kanë mbetur nga vitet paraprake 2012 dhe 2013 nga mjetet vetanake. Sot është e nevojshme që ne t’i bartim këto mjete dhe besoj se do ta aprovoni këtë propozim –vendim.

Riad Rashiti- unë kërkoj nga drejtori i Financave të jetë në prioritet që këto mjete të vitit të kaur të jenë si prioritet për shlyerje të obligimeve nga viti i kaluar, sepse ne kemi informacion që obligimet mos të paguhen nga këto mjete e që është në kundërshtim me ligjin mbi financa.

Lutfi Haziri- borxhet janë zbardh dhe janë legjitimuar dhe do të paguhen sipas kohës dhe nuk ka asnjë tendencë për ta kualifikuar ndryshe. Ne kemi filluar servisimin e borxheve sipas grumbullimeve dhe të hyrave që i kemi. Ju e dini se ai që e krijon borxhin, ai e paguan. Ne e kemi raportuar në Qeveri në mënyrë që ta kemi një mbulesë të mallrat dhe shërbimet, sepse është shpenzuar tepër.

Nuk pati debatues të tjerë për këtë pikë të rendit të punës dhe kryesuesja propozon që të aprovohet pika “c” e rendit të punës?

Aprovohet pika “C” e rendit të punës: Propozim vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2012 dhe 2013 në vitin fiskal 2014, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

d. Miratimi i Planit të punës të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2014

Sadri Arifi- në kushte normale, Kuvendi do të duhej ta zgjidhte një komision për hartimin e një plani dhe ai komision t’i parashihte të gjitha objektivat relevante dhe planin e punës të detajuar.

Ky proces ka qenë desh të ndodh para fillimit të viti kalendarik, por pasi që kemi qenë një prridhë zgjedhore, ne Shërbimi i Kuvendit dhe drejtoritë përkatëse e kemi hartuar një plan i cili ndoshta nuk është edhe i përsosur, por është një udhërrëfyes i punës së Kuvendit për vitin 2014.

Në vazhdimësi plani i punës edhe do të kompletohet dhe me siguri se do të futen edhe çështje tjera të cilat nuk janë paraparë në këtë plan.

Riad Rashiti- në emër të grupit kuvendar të PDK-së theksoi se Plani i punës ka mundësi të plotësohet, prandaj edhe unë i kam disa propozime, por e lus kryesuesen që këto propozime t’i hedh në votim, kurse Kuvendit i aprovon ose nuk aprovon këto plotësime e të cilat janë:

- në muajin prill kryetari i Komunës ta paraqet programin qeverisë katër vjeçar të Komunës së Gjilanit, sepse ne e dimë që pushteti ka pësuar ndryshime, por e dimë që qeverisja bëhet ndryshe, por është nevojshme që të na paraqitet programi qeverisës ashtu si e ka paraparë kryetari i Komunës.
- Gjithashtu kërkoj edhe një raport dhe prioritet e Qeverisë lokale për vitin 2014, 2015, 2016 dhe 2017?
- Në muajin maj kërkoj që të bëhet një raport për investimet e përgjithshme në Komunë të qoftë i ardhur nga Qeveria, dhuruesit, apo PPP etj.
- Gjithashtu kërkoj që të jetë një propozim-vendim që të mbyllet Deponia në Velekicë, për shkak të gjendjes së rëndë në të cilën gjendet ajo deponi
- Gjithashtu kërkoj që në seancën e muajit prill të planifikohet anulimi i vendimit të Komisionit Komunal për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, lagjeve dhe vendbanimeve.

Nevzad Isufi- unë propozoj që ne së pari komitetet t’i bëjmë funksionale dhe t’i epet mundësi që ata t’i japin propozimet e tyre në mënyrë që të inkorporohen në këtë plan. Për ndryshe unë konsideroj se po bëhet një anashkalim i trupave të Kuvendit, prandaj në radhë të parë komitetet të bëhen funksionale, sepse ju e dini se deri më tash vetëm KPF është funksional, kurse vetëm Komiteti i Arsimit e ka mbajtur një takim, kurse të tjerët nuk e kanë mbajtur ende asnjë takim. Është e nevojshme që kompletimi i komiteteve duhet të bëhet para se të aprovohet ky plan.

Sadullah Kadriu- pasi po e marrë fjalën për herë të parë si anëtar i Kuvendit, prandaj të gjithëve iu uroj punë të mbarë dhe suksese, sepse qytetarët të cilët na kanë zgjedhur presin punë prej neve. Në Planin e punës kam propozim konkretë dhe propozoj që në mbledhjen e ardhshme që për Kosovën Lindore të formohet edhe një komiteti veçantë, sepse ashtu edhe jemi marrë vesh. Gjithashtu në mbledhjen e ardhshme të bëhet edhe konstituimi i zyrës për Kosovën Lindore e që është ide e kahershme, të bisedohet për këtë çështje dhe të votohet në Kuvend.

Fehmi Sylejmani- unë nuk kam vërejtje, por më tepër një këshillë, sepse çdo pikë të rendit të punës para se ta propozosh për votim duhet ta konstatosh numrin e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në sallë. Kjo është rregull edhe pse nuk ju konvenon, por duhet ta pranoni!

Valentinë Bunjkau- Rexhepi – ne qysh në fillim të seancës e konstatuam prezencën!

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesja kërkon që aprovohet pika “D” e rendit të punës me propozimet dhe plotësime e z. Riad Rashiti?

Të deklarohet se kush është për këtë propozim?

Për propozimin e z. Rashiti Kuvendi i deklarosh kështu: 11 ishin për, kundër 21 dhe nuk u aprovua propozimi i z. Rashiti dhe i grupit kuvendar të PDK-së.

Valentinë Bunjkau- Rexhepi- kush është që të aprovohet pika “D” e rendit të punës ashtu siç është hartuar dhe të cilin e posedoni në material të seancës?

Aprovohet pika “D” e rendit të punës: Miratimi i Planit të punës të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2014, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 11 ishin kundër.

e. Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Sadri Arifi- ky Këshill funksionin e tij do ta kryej duke u bazuar në Udhëzimin administrativ nr.27/2012 të MPP-03/2012 duke u bazuar në Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Mandati i këtij Këshilli është i lidhur ngushtë me mandatin e Kuvendit dhe në bazë të kësaj këshilli të kaluar i ka përfunduar mandatin, prandaj sot e kemi një këshill të ri i cili do të funksionojë në bazë të udhëzimit administrativ të shënuar më lartë.

Ky këshill është i obliguar që së paku 6 seanca në vit të mbajë, kurse pagesa është ekuivalente me atë të anëtarëve të KPF-së.

Nevzad Isufi – unë edhe në KPF, kam bërë pyetje se si zgjidhet përfaqësuesi i komunitetit shqiptar në këtë përbërje?

Sadri Arifi- ashtu si i zgjedh kryetari i Komunës edhe përfaqësuesit e komuniteteve tjera, por me konsultime të komunitetit shumicë e bënë një propozim.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesja e Kuvendit kërkon që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës?

Aprovohet pika “E” e rendit të punës: Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, me 29 vota të anëtarëve të Kuvendit (të gjithë sa ishin në sallë).

Ismail Jonuzi- për shkak të agjendës të cilën e kam, kërkoj që të bëhet një ndryshim në rendin e punës dhe të tejkalohet rendi i punës dhe të fillojmë me pikën “I”: Propozim vendimi për anulimin e vendimit 01.nr.119106 dhe 119115 të datës 16.10.2012 (Komisioni komunal i aksionarëve në “Kosovatrans” dhe “Eco-Higjiena”)

Valentinë Bunjkau- Rexhepi- nga drejtori i Zhvillimit Ekonomik kërkohet që pika “I” të kalojë në radhitje më lartë, sepse sot në Komunë të Gjilanit është ministri për Zhvillim Ekonomik dhe drejtori ka tjetër agjendë.

Kusht është që të bëhet kjo zhvendosje, kurse pas kësaj pike do të vazhdojmë me punë sipas rendit të punës të cilin e keni marrë.

Aprovohet kërkesa që të debatohet pika “I” e rendit të punës me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

I. Propozim vendimi për anulimin e vendimit 01.nr.119106 dhe 119115 të datës 16.10.2012 (Komisioni komunal i aksionarëve në “Kosovatrans” dhe “Eco-Higjiena”)

Ismail Jonuzi- ne kemi kërkuar që në emër të aksionarëve të transportit urban “Kosovatrans “ dhe të PPP “Ecohigjiena” të anulohet vendimi i mëparshëm, kurse më vonë të nxirret një vendim i ri nga ky Kuvend. Arsyeja është se këto organe sipas statutit të Komunës në periudhën kohore për të cilin kanë zhvilluar aktivitetet nuk kanë sjell asnjë raport të punës të qëndrueshëm për opinionin dhe KK-në. Për këtë arsyeje ne kemi propozuar që të anulohet vendimi i mëparshëm dhe ky Kuvend të nxjerr një vendim të ri.

Sahit Abazi- drejtori po flet për shkelje ligjore, kurse vetë kjo nismë është me plotë shkelje ligjore, sepse së pari ky propozim-vendim do të duhej të diskutohet së pari në KPF. Ne në këtë komitet e patëm thënë se për këtë pikë nuk kishte përgatitje të duhura dhe kjo mund të vërtetohet nga procesverbali ku mund të shihet se në atë mbledhje nuk ka pasur asnjë dokument, asnjë letër që e sqaron ose e arsyeton atë që po e thotë sot drejtori.

Ne e dimë që pozita i ka numrat dhe mund ta kalojë këtë pikë, por duhet ditur se kjo nuk është praktikë e mirë, nuk është mirë që të merren vendime pa arsyetim, pa debate të duhura për secilën çështje. Ne kemi kërkuar që të njoftohemi me kohë dhe me arsyetime dhe pastaj mund ta propozoni këtë pikë të rendit të punës duke e konsultuar bazën ligjore për të ndërmarrë vendime të tilla.

Ne jemi kundër këtij vendimi për anulim me arsyetim se nuk ka pasur procedura të rregullta dhe konsiderojmë se ka edhe shkelje ligjore.

Valentinë Bunjkau- Rexhepi- unë e di që në KPF është diskutuar dhe ka kaluar kjo pikë e rendit të punës.

Arben Mehmeti- gjatë tërë mandatit të kaluar ish kryesuesi i Kuvendit vazhdimisht ka deklaruar se”: a po harroni se ne jemi pushteti”. Shumë herë ne kemi dëshiruar ndryshe, por realiteti dhe fuqia politike vepron më ndryshe se ajo që dëshiron dikush.

Këto gjëra kanë kaluar në KPF, por si i konsideron dikush këtë është problem i tyre.

Mirëpo unë propozoj që këtij vendimi t’ i shtohet edhe një pikë dhe të thuhet se pos këtij vendimi të bëhet edhe nominimi i anëtarëve të rinj. Ky vendim e obligon edhe kryetarin e Komunës për ta ndryshuar edhe komisionin e aksionarëve.

Mevludë Zejnullahu- në bazë të disa informatave që i posedoj është se ndërmarrja “Eco-higjiena” ka të bëjë edhe me abuzimin e të drejtave të punëtorëve. Aty ka parregullsi të mëdha, sepse punëtorëve iu lëshohet kontrata e punës vetëm për një vit, por në bazë të Ligjit të punës punëtorët të cilët i kanë mbi 10 vjet përvojë pune i lëshohet kontratë e përhershme.

Mirëpo në këtë kompani kemi punëtorë të cilët punojnë në një periudhë kohore prej 20-30 vjet, prandaj duhet analizuar dhe ndërmarrë diçka, sepse këto janë shkelje të drejtave të punëtorëve.

Sahit Abazi- ne nuk po kërkojmë diçka të palogjikshme, por ne po kërkojmë të drejta, po kërkojmë procedura. Procedurë është që ky propozim duhet të kalojë në KPF, por jo me fjalë si ka kaluar, por të kalojë me një debat mbi bazën e letrave dhe të ketë edhe referenca.

Unë përsëri po e them ju i keni numrat, por kjo është kundërligjshme.

Avdyl Aliu- nga diskutimet që po i dëgjoj po krijohet një dilemë se a kam qenë në komitet apo jo?

Mirëpo unë kam qenë në KPF dhe këtë pikë e kemi kaluar, por nuk do të thotë se votim të jetë absolut pa asnjë votë kundër. Vota është dimensionimi më themelor i demokracisë dhe në KPF është diskutuar për këtë pikë dhe kjo është rekomanduar për seancën e sotme.

Ajo që po kërkohet letra, pikërisht mungesa e letrave e ka shtyrë pozitën që të marrë këtë propozim, sepse ato kompani nuk kanë sjell asnjëherë letra në Kuvend.

Sahit Abazi- unë e kam një pyetje për shefin e grupit të LDK-së: A ka pasur propozim me letra në KPF, apo ka qenë propozim me fjalë? Të na epet ky sqarim.

Arben Mehmeti-pak më parë ne e aprovuam një vendim për formim të Këshillave në bashkësi, mirëpo e kemi pasur atë Këshill, por që ka ndryshuar qeverisja dhe askush nuk tha pse po zgjidhet këshilli i ri. Kur tash dikush preket nga kjo, ka reagime pa baza. Unë po e them se të gjitha vendimet politike të gjitha burimet i kanë në fjalë, kurse mandej vijnë edhe letrat.

Riad Rashiti- unë arsyetimet për këtë propozim-vendim i vlerësoj se janë të paqëndrueshme jo ligjore, sepse komisionet për të cilat po propozohen që të shkarkohen për këto dy kompani publike nuk janë vlerësuar raportet e tyre për vitin e ardhshëm. Këto komisione janë funksionalizuar në janar të viti 2013, prandaj koha për të raportuar para Kuvendit është marsi i këtij viti. Ne e dimë që KK dhe komitetet nuk janë themeluar deri para pak kohësh, prandaj kujt paskan pasur ata për t’ i raportuar? Kuvendi që dy muaj nuk ka mbajtur seancë, 45-50 ditë nuk ka pasur seancë nuk e di në çfarë pushimi ka qenë veror apo dimëror?

Unë kërkoj që së pari ta di a kanë pasur takim këto dy komisione me kryetarin e Komunës dhe çfarë të dhënash ka pasur me ato takime? Nuk duhet kjo çështje të politizohet, sepse komisionet e kanë nga një anëtar të LDK-së dhe keni pasur mundësi që të merrni informacione dhe ato konstatime sot t’ i keni në letër.

Për neve ky veprim është jo ligjor dhe bazohet në disa ligje të cilat nuk kanë të bëjnë asgjë me këtë çështje, prandaj ne këtë do ta procedojmë edhe në instancat e tjera.

Arben Mehmeti- përsëri po e theksoj ish kryesuesin, sepse para çdo vendimi theksonte se ju e keni MPL-në, mund ankoheni dhe iu vjen përgjigja. Prandaj tash po pyes pse edhe ju po merakoseni aq shumë? Në çastin që bëhet shumë zhurmë ka edhe elemente politike, por ky nuk është propozim politik i joni, sepse ne kemi edhe anëtarë tonë të LDK-së . Nuk qëndron ajo se ky komision është funksionalizuar në janar 2013, sepse ne e kemi vendimin se komision është formuar në muajin e dhjetë të vitit 2012. Ky është vendimi, por ata kanë pasur mundësi edhe deri më sot të mos funksionalizohen dhe të mos sjellin asnjë raport. Mirëpo edhe mos të harrojmë se një organ i cili ka të drejtë për ta nxjerr një vendim, ai e ka të drejtën edhe për anuluar ose shfuqizuar. Unë kërkoj që kjo të hidhet në votim dhe të vazhdojmë më tutje.

Bujar Nevzadi- ne jemi shumë të qartë, sepse ne edhe në KPF kemi kërkuar arsytim me shkrim, pse po ndodh kjo? Pse po kërkohet anulimi i këtij vendimi? E di që z. Arbeni e ka pushtetin, por duhet të mësohemi dhe të bazohemi në ligj, duam ta dimë mbi çfarë baze po kërkohet kjo?
Ne e dimë që janë votat, por neve na e sillni vetëm arsyetimin me shkrim dhe asgjë tjetër nuk po kërkojmë?

Riad Rashiti-po iu përkujtoj se në muajin shkurt nuk është mbajtur asnjë seancë dhe unë po i lexoj vetëm pak rreshta. KK i Gjilanit është bërë jofunksional duke u bazuar në LVL- të cilin nen e thekson. KK konsiderohet jo funksional në brenda 60 ditëve nga themelimi nuk e miraton Statutin e Komunës. Unë mendoj se ju jeni larg ligjit dhe funksionalizmit të KK-së.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesja kërkon që të aprovohet, kjo pikë e rendit të punës?

Aprovohet pika “I” e rendit të punës: Propozim vendimi për anulimin e vendimit 01.nr.119106 dhe 119115 të datës 16.10.2012 (Komisioni komunal i aksionarëve në “Kosovatrans” dhe “Eco-Higjiena”), me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, 7 ishin kundër, kurse 5 abstenime.

f. Propozim Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës Sadudin Berisha- arsyetim e kësaj pike të rendit të punës e dha drejtori i drejtorisë për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të cilin arsyetim, anëtarët e Kuvendit e kanë edhe në material të seancës.

Fehmi Sylejmnai- unë e kam një pyetje për drejtorin: çka do të thotë veprimi paraprak, sepse nuk e kam të qartë?

Sadudin Berisha-mundësia ligjore për të dhënë një pronë komunale me ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale është dhënia e pronës afatshkurtër e cila realizohet përmes konkurrencës të hapur publike dhe të bazuar në ligjin përkatës. Për dhënien e paluajtshme komunale në shfrytëzim afat shkurtër, konkursi i hapur publik është në formën e ankandit. Procedura për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës bëhet sipas procedurave të cilat rregullohen me aktet ligjore.

Të neni 7 pika 1 të cilën e citon z. Berisha. Në bazë të këtij neni ka të bëjë me një vendim paraprak që më tej kalohet në procedurat e parapara me ligj dhe me Udhëzimin administrativ për shpalljen e ankandit publik. Para se të bëhet shpallja e ankandit publik detyrimisht dy drejtoritë, Shërbimet Publike dhe ajo e Urbanizmit duhet të përcaktojnë sipërfaqet e sakta për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, sepse kemi të bëjmë me ngastra kadastrale ku trasohet rruga dhe e gjithë prona nuk epet për shfrytëzim të parkingjeve, por epet vetëm një pjesë.

Për t’u definuar kjo ngastër me sipërfaqe të nevojshme për parking para se të bëhet shpallja e ankandit publik duhet të dilet në vend të ngjarjes dhe të përkufizohet sipërfaqja. Detyrimisht KK duhet të nxjerr një vendim paraprak, sepse kryetari i Komunës nuk mund të jep asnjë pronë komunale

për pa e marrë formalisht pëlqimin përmes një vendimi të tillë nga KK. Do të thotë hyhet në një fazë tjetër të përfundimit për dhënie në shfrytëzim të këtyre pronave komunale e që nënkupton vendim paraprak.

Sokol **Haziri**- të gjitha këto hapësira kanë hyrë në fuqi dhe nuk ka një afatshmëri të njëjtë për dhënie të pronave në shfrytëzim, sepse më mirë menaxhohen përgjegjësitë e tyre. Procedurat e ankandit do të shpallen dhe konkurrenca është e lirë dhe detyrimsht duhet të jemi në vija të ligjit e të cilat gjëra janë të specifikuar qartë se cilat hapësira duhet dhënë dhe cilat jo?

Sahit Abazi- ne nuk jemi kundër kësaj, por edhe në këtë pikë ka shkelje të procedurave, sepse një vendim i tillë duhet të kalojë në Komitetin për Shërbime Publike, prandaj në parim jemi për, por kjo pikë e rendit të punës nuk i ka kaur procedurat e duhura.

Riad Rashiti – unë mendoj se ky vendim sot nuk duhet as të debatohet, sepse këtij vendimi i mungon definimi i hapësirës në mënyrë detale. Ky definim i hapësirës duhet të bëhet paraprakisht dhe jo pasi të aprovohet në Kuvend. Gjithashtu këtij vendimi i mungon edhe çmimi fillestar e cila gjë thuhet qartë në ligj që për çdo ankand publik duhet të jetë çmimi fillestar. Nëse këtij vendimi i mungon çmimi fillestar, atëherë ky vendim është i pabazuar në ligj? Mendoj se në këtë vendim janë përfshirë tri kategori të hapësirave për dhënie në shfrytëzim dhe mendoj se është një vendim i gjerë. Janë lokalet afariste për të cilat ekziston edhe një rregullore, kurse ky vendim sot është në kundërshtim me rregulloren për dhënien e lokale në shfrytëzim për pa e ditur çmimin fillestar.

Unë mendoj se duhet të jetë një ankand i posaçëm për lokale, një ankand i veçantë për parkingjet dhe tjetri për reklamat afariste. Nuk është në rregull që në një vendim të përfshihen tri kategori për dhënie të hapësirave në shfrytëzim.

Sadullah Kadriu – unë mendoj se duhet që kihet parasysh fakti se afër Shtëpisë së Mallrave kanë qenë dy parkingje për persona me aftësi të kufizuara, por unë kërkoj që të gjendet ndonjë hapësirë e përshtatshme për persona me aftësi të kufizuara, sepse siç po shihet tash është vetëm një parking i tillë, prandaj kërkoj që të destinohet edhe një parking për persona të tillë.

Arben Mehmeti-sa i përket vendimit po thuhet se nuk janë të precizuara hapësirat, por unë po e shoh se ka hapësira dhe po dihet se cilat janë. Mirëpo ne këtu ne ka qenë desh ta kemi një raport për mënyrën e menaxhimit të këtyre hapësirave në të kaluarën. Të ofrohen të dhënat sa të hyra ka pasur kush i ka menaxhuar dhe të dhënat tjera, sepse ne nuk e kemi anojë informatë. Këto parkingje duhet të menaxhohen në mënyrë ligjore, sepse tash kemi ligje të cilat e rregullojnë këtë lëmi. Ne duhet sot t' i kalojmë si vendim, sepse ky është një vendim paraprak dhe për këtë do të krijohen edhe komisionet profesionale që do të merren me këtë punë dhe neve nuk na takon të merremi me këtë punë, sepse janë komisionet nga ekzekutivi dhe Zyra Prokurimit.

Në të ardhmen të bëjmë edhe një raport për mënyrën e shfrytëzimit në periudhën e kaluar, kurse tash është mirë që ta kalojmë kështu si është.

Sokol Haziri- ne posa e miratuam një rregullore në të cilën janë të precizuara edhe disa tarifa dhe ngarkesa për raste të tilla, por këto çmime do të vlejné vetëm derisa këto parkingje të shpallen në ankand publik. Çështja e rregullores është e përkohshme.

E dyta pajtohem me Arbenin që të kemi një informacion lidhur me mënyrën e shfrytëzimit të këtyre lokaleve, kushtet e shfrytëzimit dhe dobinë që e kemi pasur nga këto lokale. Në seancën e radhës është mirë që ta kemi një informacion më të saktë për këtë çështje.

Leonorë Bunjaku- unë po e marrë fjalën në emër të një grupi të vogël të qytetarëve e të cilët janë shfrytëzues të lokaleve afariste. Ata janë me vite në ato lokale e të cilët kanë kontribuar vazhdimisht në buxhetin e Komunës, por ky numër i qytetarëve është simbolik. Ata kanë kërkuar nga kryetari dhe

përgjegjësit e tjerë që të kenë konsideratë ndaj tyre, sepse ata kanë mundësi vetëm për ta siguruar një pagë simbolike sa për ta mbajtur një familje.

Ajo e cila po më brengos është ankandi publik, prandaj a do të ketë ankand publik për shfrytëzuesit e mëparshëm, apo do të jetë ankandi vetëm për lokalet të cilat nuk janë në shfrytëzim?

Ju lus që t' i keni në konsideratë sepse merren me veprimtari të vogla dhe mezi se e sigurojnë ekzistencën për familjet e tyre, prandaj unë mendoj se buxheti i Komunës nuk do të varet nga këto lokale afariste. Kërkoj ta di se a jeni në ato parime të cilat i keni premtuar gjatë fushatës parazgjedhore? Ju janë premtuar këtyre lokaleve afariste zbritje deri në maksimum.

Sokol Haziri- modalitetet se si do të procesojë Zyra e Prokurimit nuk i di? Ndoshta është çështje e përshkrimit të atyre kushteve të cilat do t' i plotësojnë. Në parim pajtohem me atë çka e tha zonja, sepse e di që një pjesë e madhe e sigurojnë kafshatën e bukës, por edhe një pjesë e mirë krijojnë borxhet të mëdha dhe nuk i përgjigjen me korrektësi obligimet që i kanë ndaj Komunës.

Fatkeqësisht nuk është numri i madh i tyre, por ata sigurisht nuk mund të jenë të barabartë me aplikuesit e tjerë në ankand.

Leonorë Bunjaku- nga anëtarët e Kuvendit u përmenden me statistikat dhe të dhënat që unë i posedoj një numër shumë i vogël nuk i ka kryer obligimet për qira, 1 ose 2 qiramarrës, kurse të tjerët kanë qenë të rregullt.

Sokol Haziri- po më vjen keq, por unë e kam listën për ata që nuk i kanë kryer obligimet dhe ka edhe plotë të tjerë që nuk iu kanë përmbajtur obligimeve.

Nuk pati debatues të tjerë lidhur me pikë të rendit të punës, prandaj kryesuesja e Kuvendit kërkon që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës.

Aprovohet pika "F" e rendit të punës: Propozim Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës, me 24 vota të anëtarëve të Kuvendit, 3 ishin abstenime, kurse të tjerë nuk u deklaruan për asnjë variant të votimit.

Pas kësaj pike Kuvendi shkon në pushim për 10 minuta.

Pas 10 minutave, seanca i vazhdon punimet me pika tjera të rendit të punës

- g.** Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- unë së pari po e jap një formulë për themelim të këtij komisioni të cilët mund të kenë të drejtë për të qenë anëtarë të këtij komisioni.

Ne kemi menduar që formula për ta themeluar këtë komision është: 1, anëtarë nga LDK, 1 PDK, 1 AAK, kurse 3 të tjerë janë anëtarë të ekzekutivit dhe një nga shoqëria civile, gjithsej 7 anëtarë.

Nevzad Isufi- LDK dhe AAK janë koalicion, prandaj duhet një tjetër nga opozita.

Bujar Nevzadi- pajtohem me z. Isufi se një anëtar duhet të jetë nga LVV, sepse në ekzekutiv janë të njëjtit individ. Opozita duhet t' i ketë së paku dy anëtarë.

Selami Xhemajli- ne jemi në koalicion, por edhe si subjekt politik, jemi subjekti i tretë në Kuvend dhe kërkojmë që edhe ne të marrim përgjegjësi për punën e komisionit.

Bujar nevzadi- kohë të gjatë jemi këtu dhe është mirë që dy anëtarë të jenë në këtë komision nga opozita, një nga PDK dhe një nga LVV. Të jeni më zemërpur, sepse në mandatin e kaluar kemi punuar vazhdimisht, me modesti dhe nuk ka pasur grup i cili nuk është përfshirë nëpër komisione.

Izmi zeka- nëse në këtë komision mbetet vetëm një i opozitës, PDK-ja tërhiqet dhe nuk do të jetë fare në këtë komision.! Kjo është e palogjikshme, nëse nuk lejon dy anëtarë nga opozita, atëherë ne nuk po marrim pjesë.

Lidhur me këtë pikë u debatuar edhe më gjatë dhe në debat morën pjesë, Fehmi Sylejmani, Sahit Abazi, Ibish Ibishi, Nevzat Rushiti, dhe Arben Mehmeti, por nuk u gjet një koncenues.

Kryesuesja kërkoj edhe njëherë nga opozita që të jenë pjesë përbërëse e këtij komisioni, por përsëri nuk u darkordua opozita.

Kryesuesja theksoi se kërkesa dhe dëshira e jonë është që edhe opozita të jetë pjesë e këtij komisioni, por pasi opozita, nuk po e pranon formulën ashtu si e kemi propozuar ne, kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që të deklarohen se kush është për aprovim të pikës “g” të rendit të punës, pa anëtarin e PDK-së ?

Aprovohet pika “G” e rendit të punës: Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës, me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, 11 ishin kundër, kurse 1 abstenuim

h. Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit për vlerësimin e ankesave

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- ky komision duhet të jetë prej 5 anëtarëve, LDK, PDK 2 nga ekzekutivit dhe një i shoqërisë civile.

Izmi Zeka- nëse nuk e riparoni vendimin për komisionin e parë që të aty jetë edhe një anëtarë nga opozita (gjithsej 2), ne nuk do të marrim pjesë as në këtë komision.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- se ato do jenë pjesë e këtij Komisioni PDK, apo jo ata të vendosin vetë, prandaj ju lus që të deklaroheni se kush është që komision të përbëhet sipas formulës që e theksova.

Aprovohet pika “H” e rendit të punës: Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit për vlerësimin e ankesave, me 17 vota të anëtarëve të Kuvendit, 12 ishin kundër dhe 4 ishin abstenuime.

Sadudin Berisha- është mundësia e partive opozitare dhe atyre të pozitës për t’ u marrë vesh për ndarjen e tri vendeve, por nëse nuk arrihet kjo, atëherë shkon grupimi tjetër politik i cili është më i madh. E njëjta vlen edhe për komisionin e parë.

Selami Xhemajli- nëse PDK heq dorë nga pjesëmarrja, atëherë i mbetet LVV që ta delegojë anëtarin e vetë, mirëpo nëse LVV nuk e dërgon përfaqësuesin e vetë, atëherë kërkoj që edhe në këtë komision për vlerësim të ankesave ta kemi përfaqësuesin tonë nga AAK.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- atëherë nëse PDK, por as LVV nuk e delegojnë përfaqësuesin e vetë, atëherë propozoj që ky komision të përbëhet sipas kësaj formule: LDK, AAK, ekzekutiv dhe anëtarë i shoqërisë civile. Kush është për këtë propozim të deklarohet?

Aprovohet pika “H” e rendit të punës: Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit për vlerësimin e ankesave, me 17 vota të anëtarëve të Kuvendit, 12 ishin kundër dhe 4 ishin abstenuime.

- i. Propozim vendimi për anulimin e vendimit 01.nr.119106 dhe 119115 të datës 16.10.2012 (Komisioni komunal i aksionarëve në “Kosovatrans” dhe “Eco-Higjiena”)**

Pikë “I” e rendit të punës është shqyrtuar më parë dhe është marrë vendimi.

j. Zgjedhja e tre anëtarëve nga KK-Gjilan, në Kuvendin e AKK-së
Valentinë Bunjaku-Rexhepi – në KPF, kemi marrë propozimet që nga LDK të jetë, Valentinë Bunjaku –Rexhepi, PDK- Sahit Abazi, kurse nga AAK- Adelinë Berisha.

Kush është për këtë propozim?

Aprovohet pika “J” e rendit të punës: Zgjedhja e tre anëtarëve nga KK-Gjilan, në Kuvendin e AKK-së, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, 5 ishin kundër, kurse 2 abstenime.

Ismet Hajdini- ju lutem zonja kryesuese a ekzistojmë ne apo jo në këtë Kuvend? Ne jemi disa subjekte dhe vazhdimisht po anashkalohe mi, prandaj të keni konsideratë herëve të tjera.

k Diskutim rreth Kompensimit të Komisionit të përhershëm statutar dhe akte tjera normative

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- në KPF e kemi pranuar një kërkesë me të cilën ky Komision kërkon që për çdo seancë ky komision të kompensohet nga 70 €, por deri në tri seanca për një muaj. Mirëpo kërkesa që e ka bërë ky komision është e lartë, sepse nuk kemi mundësi buxhetore, por unë propozoj që ky komision të kompensohet me një paushallë për plotësim dhe ndryshim të statutit.

Arben Mehmeti- ky është një komision statutar, për plotësim dhe ndryshim të statutit dhe akteve tjera normative për të cilin komision është marrë vendim në Kuvend. Ky komision nuk krahasohet me trupat e tjerë të Kuvendit, sepse e ka një rëndësi të veçantë dhe ka të bëjë me legjislacion komunal. Ky komision është përbërë sipas përfaqësimit të partive politike dhe po theksoj se është një komision profesional dhe i rëndësishëm së veçantë. Ka qenë kërkesa për 70 € për seanca e të cilat mund të mbahen maksimalisht, kur duhet të hartohen rregullore dhe akte të tjera normative. Është punë e Kuvendit për të vendos, por nuk është mirë të anashkalohe mi trupat e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, debatuan shumë anëtarë të Kuvendit, por kryesuesja propozoj si në vijim.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- unë propozoj që Komision për plotësim dhe ndryshim të statutit të Komunës të kompensohet me një shumë simbolike paushallë me 150 € për çdo anëtarë.

Aprovohet pika “K” e rendit të punës: Diskutim rreth Kompensimit të Komisionit të përhershëm statutar dhe akte tjera normative, që kompensimi të bëhet në formë paushalli prej 150€, me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, 12 ishin kundër, kurse 1 abstenim.

5. Të ndryshme

Isa Agushi- unë në seancën e dytë apo të tretë të Kuvendit e kam ngritur çështjen e Shtëpisë së Kulturës në Zhegër e cila veç ka hyrë në procedurë të privatizimit nga AKP. Mirëpo më 13 mars është bërë një lloj ankandi publik, për të cilin rast banorët e Zhegrës kanë shqetësime, prandaj unë kërkoj që sot ose në seancën e radhës të jetë në rend pune ky shqetësim i banorëve të Zhegrës .

Besë Baftia –unë e përkrahi iniciativën e anëtarit të Kuvendit nga Zhegra Isa Agushi i cili edhe në seancën e kaluar e ka ngrit këtë çështje, por unë mendoj se kjo nuk duhet të lihet për seancën e ardhshme, por sot urgjentisht Kuvendi duhet të merr vendim që të ndalojë këtë privatizim, sepse është i paligjshëm. Të gjithë e dinë se në mënyrë të paligjshme ato prona iu kanë dhënë Kooperativës Bujqësore në vitet e “80, kur kanë qenë masat e dhunshme.

Ne si LVV kërkojmë që Kuvendi të merr vendim urgjent dhe ta ndalojë këtë privatizim.

Sahit Abazi- edhe grupi kuvendar i PDK-së e përkrah kërkesën e anëtarit të Kuvendit z. Isa Agushi. Edhe pse Kuvendi ndoshta nuk ka të drejtë të merr ndonjë vendim të tillë, por në parim e mbështesim, sepse ajo është për nevojat e qytetarëve të banorëve të Zhegrës.

Selami Xhemajli- edhe ne si grup i AAK-së e mbështesim kërkesën e qytetarëve të Zhegrës të cilën kërkesë apo shqetësim e paraqiti z. Agushi. Ne jemi për atë që të japim një rekomandim për mos privatizimin e kësaj hapësire.

Sergjan Mitroviç- lidhur me propozimin të cilin e bënë kolegët nga Zhegra dhe e përkrahën të gjithë të tjerët, gjithashtu edhe unë e kam një propozim që edhe Kooperativa Bujqësore në Shillovë e cila do të hyjë në procedurë të privatizimit ashtu si po reagohej për objektin në fshatin Zhegër të bëhet i njëjti reagim, apo të merret i njëjti vendim edhe për Kooperativën Bujqësore të Shillovës.

Veletinë Bunjaku-Rexhepi- u morëm vesh që ta bëjmë një reagim edhe për Zhegër dhe Shillovë.

Nevzad Isufi- ne kërkojmë që për ta ditur se a janë këto raste të dyja të ngjashme apo jo? Të sillen informacione shtesë për këtë rastin tjetër, pastaj në seancën e radhës mund ta diskutojmë.

Shpresë Kurteshi- nga ana e opozitës u kërkuar që të jepen informata lidhur me udhëtimet kryetarit të Komunës jashtë vendit, por pasi që kam qenë bashkudhëtare e kryetarit ta informoj Kuvendin si në vijim.. Unë dhe një grup së bashku me kryetarin, në Hagë kemi qëndruar dy javë me ftesë të USAID-it Amerikan dhe këtë qëndrim tonin në tërësi e ka financuar USAID-i Amerikan dhe nuk kemi shpenzuar asgjë nga buxheti i Komunës. Gjithashtu gjatë kësaj vizite, kryetari i Komunës i ka realizuar edhe disa vizita zyrtare.

Avdyll Aliu- edhe ne në emër të grupit kuvendar të LDK-së e përkrahim kërkesën e z. Agushi.

Sokol Haziri- për hapësira publike, kryetari i Komunës ka të drejtë të negociojë me AKP-në që hapësirat të cilat janë të nevojshme për Komunën, AKP të mos i privatizojë. Lidhur me këtë Këshilli i fshatit Zhegër dhe KK, mund ta japin një rekomandim që ta ndalin këtë proces. Kjo është rruga më e drejtë dhe ne si Kuvend këtë vetëm mund ta mbështesim.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi – kryetari Haziri është duke negociuar, por ne si Kuvend kërkoj që ta votojmë një reagim tonin në mënyrë unanime që ato hapësira të mos privatizohen.

Nami Musa- lidhur me këtë unë mendoj se nuk është vetëm ky problem në Zhegër me AKP-në, por problemi më i madh është te shkollat. Ne e kemi rastin e “Integrit” i cili është rast kontestues, mandej e kemi pronën e ish Kombinatit Bujqësor për Shkollën Bujqësore e cila ka nevojë për një sipërfaqe të tokës për të filluar me mbjellje të produkteve bujqësore dhe për ta bërë punën praktike nxënësit e asaj shkolle. Në shkollë kanë arritur farëra të produkteve bujqësore, por edhe 10 krerë lopë, por ne nuk e dimë se ku t’i mbjellim ato prodhime bujqësore dhe si do t’i ushqejmë ato lopë, kurse në anën prona ka mbetur plotë thera dhe nuk ka kush t’i punojë. Për këtë arsyeje edhe kjo çështje duhet të jetë zëri i këtij Kuvendi që këto prona t’i barten kësaj shkolle.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- kush është që për këto prona (për të gjitha duke përfshirë Kooperativën Bujqësore të Zhegrës dhe Shillovës dhe pronat të cilat i ceku z. drejtori Nazmi Musa të bëhet një reagim nga KK ?

Aprovohet kërkesa e kryesues me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

Arben Maliqi- unë e kam një pyetje dhe një kërkesë për drejtorin e Urbanizmit dhe atë Inspeksionit për objektin (shtëpinë) e cila është prapa Stacionit të Autobusëve e cila paraqet rrezik të madh për banorët e asaj lagjeje. Ne këtë e kemi aprovuar në Kuvend, por tash duhet të bëhet ekzektimi dhe ajo shtëpi duhet të rrënohet. Aty ka papastërti dhe sillen persona të cilët nuk janë të dëshirueshëm për atë lagje!

Fehmi Sylejmani- unë i kam drejtuar dy pyetje për drejtorin e arsimit e të cilat i keni edhe ju anëtarë të Kuvendit, por edhe kryetari i Komunës. Unë nuk kam bërë propozime kur është aprovuar rendi i ditës, por pasi që është drejtori i Arsimit këtu është mirë që ta epet një sqarim.

Pyetjet të cilat ia kam bërë janë: 1. Drejtori i Arsimit të na informojë hollësisht sa shkolla të Komunës ngrohen me derivate të naftës ose mazut dhe se drejtori a kanë ndërmarrë diçka për ta verifikuar cilësinë e këtyre lëndëve djegëse ?

2. Kërkesë për të verifikuar saktësisht sa punëtorë arsimor janë duke punuar aktualisht në procesin mësimor, për pa i përfillur procedurat e Konkursit? Si do të veproni me ata mësimdhënës, a do t' i shpallet vendi i punës siç e kërkon ligji? Mandej kemi kërkuar emrat dhe mbiemrat e të gjithë mësimdhënësve që punojnë në Komunë të Gjiçanit të punësuar pa konkurs, shkollën në të cilën punojnë dhe kur e kanë filluar punën? Kush do të jep përgjegjësi për këto papërgjegjësi të cilat e kanë përcjell arsimin gjilanas dhe në fund sa jeni të gatshëm që ta ndërprejnë njëherë e përgjithmonë këtë praktikë ?

Nami Musa- I nderuar z. Fehmi Sylejmani, këshilltar i Kuvendit Komunal

Kërkesës suaj për të verifikuar saktësisht, se sa punonjës arsimor aktualisht janë duke punuar në procesin mësimor, pa i përfillur fare procedurat e konkursit, po ju përgjigjem me korrektësi:

Pa përfillur procedurën e konkursit në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe para fillorët:

Punonjës, orë të lira (vende të punës)	29
Punonjës në zëvendësime të pushimeve të lehonisë	24
Punonjës në zëvendësime pa pagesë	7
Punonjës në zëvendësim të atyre të pensionuar	5

Në arsimin e mesëm të lartë:

Punonjës, orë të lira (vende të punës)	17
Punonjës , në zëvendësim të pushimeve të lehonisë	12
Punonjës në zëvendësim pa pagesë	5
Dorëheqje.....	3

Arsyet

e

dorëheqjes _____

Pranimi në punë i nëpunësve- stafit ndihmës nga data 01.09.2013, pa procedurë të rekrutimit dhe të cilët janë në kompani private të "SASI" dhe "ARIANITI":

Fokist, rojtarë, mirëmbajtës	7
Pastrues	19

Pyetja: Si do të veproni ju ?

Ne do të veprojmë e bëjmë atë që thotë ligji, e ligji udhëzon që për raste të këtilla duhet shpallur konkurs për pranim e zëvendësim, sidomos për orët e lira, pushimet e lehonisë dhe vendet e lira të atyre që shkojnë në pension. Ne këtë edhe e kemi bërë tani dhe kemi shpallur konkurs; nr. 05-061-12603 të datës 03.02.2014, për këto lëndë dhe në këto institucione EA:

1. Shkolla Fillore " Zabeli" Një mësimdhënës i lëndës edukatë qytetare
2. Shkolla Fillore " Musa Zajmi" Një mësimdhënës të ciklit klasor
3. Shkolla Fillore " Agim Ramadani" Një mësimdhënës për lëndën e Matematikës

- | | |
|-------------------------------------|---|
| 4. Shkolla Filllore “Lagja II” | Një mësimdhënës i lëndës së Biologjisë |
| 5. Shkolla Filllore “Fetah Qerimi” | Një mësimdhënës të ciklit klasor-pushim lehonie |
| 6. Shkolla Filllore” Rexhep Elmazi” | Një mësimdhënës të ciklit klasor-pushim lehonie |

Të gjithë këta mësimdhënës do të pranohen me kontratë pune me kohëzgjatje deri më 30.06.2014.

DKA-ja, pas një analize të mirëfilltë për të gjitha vendet e lira për mësimdhënie e staf tjetër teknik e administrativ ,do të shpallë konkurs të rregullt për vitin e ardhshëm mësimor. Korrigjimet e pranimit të punonjësve të arsimit pa procedurë konkursi, që janë pranuar nga shtatori i vitit të kaluar,nuk i kem bërë me arsyen se, jo vetëm së çrregullohet procesi mësimor,por edhe për arsye se viti i ardhshëm shkollor do te jete vit i reformave dhe numri i punëtorëve arsimorë mund të zvogëlohet,pasi pritet që klasat e XIII-ta të mos funksionojnë në Arsimin e Mesëm t Lartë, andaj duhet të punojmë vëmendshëm.

Unë, drejtor i arsimit, nuk do të lejoj caktimin e zëvendësimeve pa procedurë të rregullt ligjore të rekrutimit,por rregullisht dhe me kohë do të shpallet konkursi për vendet e lira të punës: pensionime, dorëheqje, pushim të lehonisë, përjashtimisht rasteve të pushimeve mjekësore apo pa pagesë në periudha të shkurta.

Të gjitha të dhënat për pranim në vendet e punës pa procedurë konkursi i kem në regjistër: Emri dhe mbiemri, institucioni/shkolla, lënda, data e fillimit,data e përfundimit, lloji i zëvendësimit,por nuk mund tua jap,për arsye të ruajtjes së kredibilitetit të punonjësve arsimor. Ata kanë pasur nevojë për punë dhe nuk janë fajtor për mospërfillje të procedurës së rekrutimit përmes konkursit.

2. Të nderuar këshilltarë te Asamblesë Komunale te Gjilanit!

Duke marre ne konsiderate shqetësimet e kohëve te fundit lidhur me cilësinë dhe llojin e derivateve te naftës te cilat përdoren si lëndë djegëse për ngrohje ne disa (numrin e tyre)institucione shkollore dhe parashkollore si dhe ne disa institucione tjera komunale, si dhe duke u nisur nga interesimet e GP te Vetëvendosjes, Unë si drejtor i Drejtorisë Komunale te Arsimit, kam kërkuar informacionet e nevojshme për te gjitha çështjet qe ndërlidhen me këtë veprim si : shpallja e tenderit, kontrata e shërbimit, furnizimi me lendet djegëse, kualitetin e ngrohjes, gjendjen e stabilimenteve dhe rrjetit te ngrohjes , afatet e furnizimit si dhe ankesat eventuale .

Bazuar ne Kontratën e Furnizimit te datës 03.10.2012, me numër identifikues **Gi 651 13 084 121**, e cila është nënshkruar nga Autoriteti kontraktues (ne këtë rast Komuna e Gjilanit) dhe N.T.P. “Flamuri” (Furnizuesi), Komuna e Gjilanit natyrisht pasi ka zhvilluar të gjitha procedurat e prokurimit dhe në harmoni me aktet tjera normative, ka nënshkruar Kontratën për ofrimin e shërbimeve “ Furnizim me naftë për ngrohje për te gjitha njësitë shpenzuese te Komunës se Gjilanit “ Lot II

Siç shihet nga elementet e Kontratës, behet fjale për naftë për ngrohje, në të cilën Kontratë furnizimi përveç specifikimeve administrative dhe origjinën e mallit qe gjithsesi duhet të jetë ne përputhshmëri me Kodin e Doganave te Bashkësisë Evropiane, nuk përmban ndonjë element tjetër si; llojin e derivatit, cilësinë, substituentët eventual apo ndonjë specifikë tjetër!

Nga shkresat e lëndës te cilat ndodhen ne dosjen e tenderit dhe dokumentet përcjellëse me rastin e furnizimeve, shihet se institucionet te cilat ngrohen me naftë, iu liferohet apo furnizohen me **Euro Dizel**.

Unë si drejtor i Drejtorisë se Arsimit, jam i obliguar t’i referohem Kontratës për ofrimin e shërbimeve.

Dilemat eventuale gjate përmbushjes se detyrimeve dypalëshe që janë subjekt i kësaj Kontrate janë subjekt i palëve nënshkruese (ne këtë rast Zyrës se Prokurimit te Komunës se Gjilanit dhe furnitorit) ndërsa kontrollin e kualitetit te naftës dhe derivateve te saj, nuk janë nën autoritetin e organeve komunale, por janë përgjegjësi e Ministrisë Tregtisë dhe Industrisë!

Në bazë te Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-138) dhe UA 07/2012 për derivatet që përdoren për ngrohje, përgjegjësinë për mbikëqyrjen e cilësisë se derivateve te naftës e kanë **Trupat Inspektuese te Autorizuara** nga ana e ministrit te Ministrisë se Tregtisë dhe Industrisë , ndërsa kualitetin e derivateve te naftës, e kontrollojnë **Laboratorët Testues te certifikuar** dhe te **autorizuar** nga ana e **Ministrit** të MTI-se!

Deri me tani, nuk është shënuar ndonjë ankesë apo shqetësim lidhur me përmbushjen e Kontratës!

Për çdo dilemë apo mëdyshje për cilësinë apo llojin e derivateve te naftës, duhet t'i drejtohem institucioneve relevante , por deri sa nuk kemi ndonjë ankesë rreth këtyre çështjeve, konsideroj se duhet t'i leme hapësirë organeve te autorizuar ta bëjnë punën e tyre. Çdo kërkesë eventuale e jona sigurisht qe përcillet me një kosto te larte financiare. Ne gjendjen ne te cilën ndodhemi Ne, nuk shohim te arsyeshme ta ndërmarrim një hap te tille, pasi veç me këtë çështje janë duke u marre vazhdimisht organet e specializuara te institucioneve kompetente, ne këtë rast Doganat e Kosovës dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

A janë përzgjedhë Trupat Inspektuese dhe laboratorët testues me të mirët, kjo është kompetencë qe nuk bie nen domenin e përgjigjeve te autoriteteve komunale.

Ju bëj me dije qe Kontrata e shërbimit për furnizim me lëndë djegëse është VALIDE deri me 30.05.2014 andaj në tenderin e ri , ju siguroj qe do të specifikohen te gjitha detajet konformë dhe në harmoni me legjislacionin përkatës qe mbulon këtë fushë

Bujar Nevzadi- e falënderoj drejtorin për këtë informatë dhe unë besoj se shumë që është e saktë, por për hir të opinionit dëshiroj t' i them drejtorit që të qëndrojë prapa këtyre fjalëve. Mirëpo po të shkojmë sot ne në ndonjë shkollë, drejtori me siguri i ka pranuar së paku 10 mësimdhënës ad-hok. Ka pushime mjekësore, ka raste të vdekjeve siç e patëm tash me edukatoren, mandej janë rastet e lindjes etj. Drejtoria e Arsimit është specifike, prandaj drejtorit të Arsimit i uroj punë të mbarë dhe dëshirojë që këto që i tha mos t' i harrojë dhe t' i qëndrojë besnik fjalëve të tij.

Leonorë Bunjaku- unë në emër të grupit të PDK-së po e paraqes një problematikë të cilën besoj se askush nuk do ta kundërshtojë e që kjo kërkesë është që të integrohen psikologët në shkollat tona të të gjitha niveleve. Kohëve të fundit infrastruktura shkollore ka avancuar dhe avancimi në dobi të cilësisë së arsimit po vazhdon, por ajo e cila po na brengos është siguria nëpër shkolla. Arsytet pse ndodh kjo janë shumë faktor, por për ta penguar këtë të keqe integrimi i psikologëve është nevoja e domosdoshme në shkollat tona. Nuk është arsyetim se nuk bëhet integrimi i psikologëve me arsyetim se nuk ka buxhet. Unë ka informacione se integrimi i psikologëve kryesisht varet nga Komuna për të cilin propozim duhet bërë përpjekje serioze, sepse te ne psikologët janë të papunë, kurse shkollat pa psikolog.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- sa për informatën e zonjës Bunjaku dhe të tjerëve po iu njoftojmë se në programin tonë qeverisë në të gjitha shkollat do të këtë edhe zëvendës drejtor edhe psikolog, sepse këtë e kemi edhe në program.

Nazmi Musa- unë e kam një përvojë në arsim dhe nuk më lejohet të them se nuk duhet pedagogu dhe psikologu në shkollat tona, ata gjithsesi duhet të jenë pjesë e procesit edukativo-arsimor.

Ne në këtë sallë e kemi pasur një takim publik ku kanë marrë pjesë edhe psikologët dhe pedagogët dhe strukturat e tjera politike dhe aty është thënë se si nevojë e domosdoshme e shkollave është edhe pedagogu dhe psikologu. Në fakt institucionet tona edukativo-arsimore nëse nuk i kanë edhe pedagogët dhe psikologët, pak mund të quhen edukative, sepse me çështje të edukatës merret pedagogjia. Unë këtë çështje e kam biseduar edhe me drejtorët e drejtorive në prani të ministrit të arsimit, por nuk kam gjetur përkrahje për shkak të mungesës së buxhetit. Mirëpo në një të ardhme jo të largët, besoj se shkollat tona do të kompletohen edhe me këtë kuadër.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- unë po përgjigjen në pyetjen e shefit të grupit të PDK-së i cili ka pyetur, pse një anëtare e Kuvendit edhe mban e postin e zëvendësdrejtores? Në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 6/2008, thuhet se pozita e kryesueses është pozitë e cila merr kompensim dhe jo rrogë, prandaj e kam të drejtën që të jem edhe kryesuese edhe mësimdhënëse. Mirëpo unë duhet të përcaktohem për një pagë bazë dhe për këtë pagë bazë unë jam përcaktuar.

Sa i përket anëtares Komunale e cila është edhe zëvendësdrejtores dhe anëtar e Asamblesë Komunale ne kemi kërkuar nga MPL për të na dhënë një interpretim, por ende nuk kemi marrë përgjigje, porsa ta marrim përgjigjen do të veprojmë konformë ligjit.

Sadullah Kadriu- unë kërkoj që në rend pune të seancës së ardhshme të debatohet për problemet të cilat i kanë qytetarët e Kosovës Lindore me nënshtetësi. Ne kemi bërë një statistikë dhe mbi 1 mijë qytetarë mbi 15 vite jetojnë në Gjilan, por nuk kanë nënshtetësi. Ne si Kuvend është mirë, por edhe obligim që t' i bëjmë presion MPB-së që të bëjnë lehtësira në lëshim të dokumenteve për këta qytetarë të Kosovës Lindore.

Sahit Abazi- më vjen mirë që kryesuesja qenka përcaktuar për rrogën bazë, por sa i përket anëtares tjetër të Kuvendit, unë jam i bindur se nuk është larg MPL-ja dhe këto gjëra dihen mirë, sepse ne e kemi pasur një rast të tillë dhe anëtarja e Kuvendit të PDK-së është detyruar për të dhënë dorëheqje nga njëri post.

Mandej po pyes se çka ka ndërmarrë kryetari i Komunës në rastin e rrahjes fizike në mes dy zyrtarëve Komunal, por pasi që nuk është kryetari prezent, unë këtë përgjigje e pres në seancën e radhës.

Fehmi Sylejmani- zonja kryesuese është desh ta mbash fjalën, sepse ka qenë edhe informatë edhe sqarim, por kam pyetje shtesë për drejtorin e Arsimit. Me disa përgjigje të drejtorit nuk jam i kënaqur edhe pse kam shumë respekt për profesorin tim, por ai duhet të punojë me letra e të cilit i uroj punë të mbarë dhe të suksesshme.

Nevzad Isufi- në një mbledhje të kaluar të Kuvendit kemi kërkuar transparencë më të madhe në punë të Kuvendit dhe po na duhet që ta përmendim termin “dietë” i cili po citohet shpesh. Mirëpo jo të gjitha dietat janë të shëndetshme e rasti konkretë është se është thënë se nuk mund ta transmetojmë drejtpërdrejtë seancën. Mirëpo ka mundësi që me një flet A4 në panot e qytetit qytetarët të njoftohen me rendin e punës dhe për çka do të debatohet në Kuvend, kjo mangësi na detyron të pyesim se ku është transparenca?

Mirëpo pasi që drejtori i Inspeksionit shkoi, por unë e kam një pyetje për punimet të cilat po i bënë Kompania “Hip Petrol” në pronë të pa lejuar dhe të pa destinuar për ndërtim me leje. Për këtë shtrohet pyetja se çfarë ka bërë Inspeksioni për këtë ndërtim kundërligjor?

Shukrie Rapuca- unë në fillim të rendit të punës kam kërkuar informatë nga drejtori i Arsimit lidhur me ndërprerjen e bartjes së nxënësve në Malësi të Zhëgocit, por edhe në Kravaricë e të cilët nxënës kanë udhëtuar me një minibus në drejtimin Kravaricë-Shkolla e Mesme e Bujqësisë. Në ditën që është ndërprerë bartja e nxënësve në këtë drejtim, disa nxënës nuk i vijnë më mësimet në këtë shkollë.

Pse ka ndodhur kështu? Është kjo mungesë e mos njohjes së problemit, apo mungesë e përgjegjësisë, apo mungesë e mjeteve buxhetore?

Nami Musa- rasti për bartje të nxënësve, po më tërheq për gjuhët për të thënë se ka ngjyrë politike dhe ekskluzivisht politik. Pas kësaj politik, ka karakter komercial, pas kësaj komerciales është buxheti i cili nuk i plotëson kushtet. Po them ngjyrë politike, sepse gjatë fushatës zgjedhore janë dhënë premtime në të gjitha format dhe mënyrat. Ne e kemi formuar një komision prej tre anëtarëve dhe e kemi shikuar se cilat janë ato vija transportuese? Disa janë me tender, disa pa tender, disa janë me kompensim të naftës e që është në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu çmimet janë marramendëse, sepse në bazë të asaj vlere të cilën e ka bërë komisioni, sepse 38 mijë € është shuma mujore, kurse për një vit janë 380 mijë €. Unë po e shtroj pyetjen se më mirë është që t' i japim 380 mijë € nxënësve të cilët e thyejnë ligjin, apo ta ndërtojmë një çerdhe, sepse për një çerdhe paguajmë qira 180 € qira mujore. Mua më duket që të kërkohet diçka për ta thyer ligjin është kundër produktive, sepse ligji thotë: “Komuna është e obliguar që nxënësve të arsimit të mesëm të ulët që nga klasa e parë deri në të nëntën që udhetojnë në largësi mbi 4 km, nga shtëpia në shkollë, Komuna i merr përgjegjësitë e shpenzimeve për këta nxënës”. Këtu i është dhënë publicitet shumë Livoçit të Poshtëm e që nuk i plotëson këto kritere për transport në bazë të asaj që e thash. Në krye të këtyre pakënaqësive qëndron personi NN i cili bënë organizime të tilla, sepse ka interesa financiare. Autobusi Gjilan –Përlepnice qarkullon 10-12 herë në ditë dhe të bëjmë ne transport, atëherë po e dëmtojmë buxhetin pa arsyeje. Këto që i kemi ndërmarrë ne është mbështetje në ligj, por është edhe një racionalizim i buxhetit. Askund nuk shkruan që duhet të barten të gjithë nxënësit dhe studentët, mirëpo nëse ju e merrni një vendim të tillë, atëherë nuk do të ketë problem.

Florinë Jerliu- unë do ta sqaroj pozitën time edhe si anëtare e Kuvendit dhe si zëvendësdyrektore, për të cilin rast iu kam drejtuar Zyrës Ligjore e cila i ka kërkuar interpretim ligjor nga MPL, por ende nuk është kthyer përgjigje. Unë jam plotësisht e vetëdijshme se jam duke i mbajtur dy pozicione, por në çastin që vije ndonjë përgjigje nga MPL, unë do të deklarohej para juve dhe do të veproja sipas ligjit të interpretuar nga MPL dhe do ta zgjedh njërin pozicion.

Bujar Nevzadi- unë dëshiroj që drejtori i Arsimit që ta respektojë ligjin ashtu siç po thotë për cilin shumë shpresoj, por me siguri nuk do të mundet, sepse janë disa raste specifike. Drejtori kur të del në terren i vëren se çfarë vështirësish kanë nxënësit gjatë udhëtimit. Ka raste të rënda si rrugët pa trotuare dhe po t' i ndodh drejtorit ndonjë fatkeqësi për këtë arsyeje si KK dhe kryetari i Komunës, drejtori i Arsimit do të jenë fajtor.

Mandej ka edhe raste sociale të cilëve ia kemi kompensuar udhëtimin nga vullneti i mirë për ta mos e ndërprerë nxënësit mësimin. Unë dëshiroj që drejtori ta respektojë ligjin në mënyrë decitive.

Sahit Abazi- lidhur me rastin e anëtares së Kuvendit, zonjës Florinë përveç MPL-së të cilës iu ka drejtuar, por kjo ka mundësi për t' iu drejtuar edhe 5-6 shkallë të gjykatave për ta vonuar sa më tepër këtë tendencë (për t' i mbajtur dy pozita).

Arben Maliqi- unë mendoj se transporti i nxënësve është një ndër punët më të mira e cila ka mundur të ndodh dhe nuk duhet kursyer shumë për këtë rast, sepse mund të ndodh që të vije edhe në raste fatale. Po të ndodh vetëm një rast i tillë fatal, nuk do të ketë asnjë arsyeje. Ne e dimë shumë mirë se nuk kemi trotuare, nuk kemi rrugë të asfaltuara dhe na duhet shumë kujdes për fëmijët tanë.

Me këto pika të rendit të punës seanca i përfundoi punimet në ora 15.45 minuta, kurse kryesuesja i falënderoi të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe të tjerët për kontributin e dhënë.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjaku-Rexhepi